



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Vlerësim Kombëtar

(Për nxënësit e klasës III dhe V)

Lëndët:

Gjuhë shqipe

Matematikë

Dituri Natyre

Hyrje

Raporti publik “Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së 3^{-të} dhe të 5^{-të}, të arsimit të detyruar, viti shkollor 2013-2014, në lëndët matematikë, gjuhë shqipe dhe dituri natyre”, synon:

- të paraqesë në mënyrë përshkruese dhe statistikore arritjet e nxënësve në klasën e 3^{-të} dhe të 5^{-të}, në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.
- të japë informacion për autoritet arsimore dhe publikun e gjerë, për rezultatet e nxënësve në këto klasa, për periudhën shtator-prill 2013 -2014.

Raporti jep të dhëna në nivel kombëtar për arritjet e nxënësve në shkollat publike dhe private të arsimit të detyruar. Gjithashtu, në këtë raport jepen të dhëna për arritjet e nxënësve sipas përkatësisë gjinore, meshkuj-femra, urbanizimit fshat-qytet si dhe për karakteristikat e testeve të provimit në tërësi apo kërkesave të testeve në veçanti.

Të dhënat e mësipërme janë paraqitur në mënyrë tabelare e grafike, të shoqëruara me shpjegimet përkatëse, duke i mundësuar specialistëve të interesuar dhe publikut të gjerë të nxjerrin në pah ndryshimet dhe ngjashmëritë e arritjeve midis grupimeve të ndryshme të popullatës së testuar. Gjithashtu, analiza e përmbajtjes së kërkesave të testit do t’u mundësojë atyre të gjykojnë për nivelin e aftësive dhe dijeve që zotërojnë nxënësit e klasës së 3^{-të} dhe të 5^{-të}, në lëndët bazë: gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

Rezultatet e vlerësimeve kombëtare janë një tregues shumë i rëndësishëm, por që nuk janë të vetmet prej të cilave të nxjerrim përfundime për vlerësimin e shkollës apo sistemit arsimor në tërësi. Në gjykimin e këtyre rezultateve duhen marrë në konsideratë edhe karakteristikat e shkollave apo nxënësve, të cilat ndikojnë në arritjet e këtyre të fundit.

Analiza e arritjeve të nxënësve në këtë vlerësim kombëtar, të paraqitur në këtë raport, nuk është e lidhur me këto karakteristika.

Ky raport është pjesa e dytë e studimit në lidhje me arritjet e nxënësve. Ky testim, për shkak të kohës së pamjaftueshme, nuk u parapri nga përgatitja e një paktete të plotë vlerësimi, që nënkupton shoqërimin e testit me pyetësorët përkatës (i nxënësit, i mësuesit dhe i shkollës). Për këtë arsye edhe vlerësimin mund t’i mungojnë disa aspekte interpretimi të të gjithë faktorëve që varen nga kjo paketë.

Ky studim u realizua në muajin maj 2014. Përmes tij synuam të kemi një tablo shumë më të qartë dhe të detajuar në lidhje me nivelin e kompetencave që nxënësit zotërojnë në këto klasa të arsimit të detyruar.

Formati i raportit

Raporti është i ndarë në tri pjesë:

Pjesa I

1. Njohuritë dhe aftësitë e vlerësuara
2. Arritjet e nxënësve
3. Gjetjet
4. Përfundimet
5. Rekomandimet

Pjesa II – Raporti teknik Klasa III

1. Si u realizua procesi i testimit
2. Të dhëna dhe përfundime në testi e gjuhës shqipe;
3. Të dhëna dhe përfundime në testin e matematikës;
4. Të dhëna dhe përfundime në testin e diturisë së natyrës.

Pjesa III – Raporti teknik Klasa V

1. të dhëna dhe përfundime në lidhje me testin e kombinuar.
2. të dhëna dhe përfundime në testi e gjuhës shqipe;
3. të dhëna dhe përfundime në testin e matematikës;
4. të dhëna dhe përfundime në testin e diturisë së natyrës.

Shtojca

- Testi i klasës III
- Testi i klasës V

PJESA I

Çfarë njohurish dhe aftësish janë vlerësuar?

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve në klasën e 3^{-të} dhe të 5^{-të} të arsimit të detyruar synonte të vlerësonte njohuritë dhe kompetencat bazë të fituara për periudhën shtator-prill 2013-2014, nga nxënësit në ciklin fillor, në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre. Njëkohësisht u vlerësuan aftësitë e nxënësve për të mbajtur qëndrime aktive ndaj njohurive dhe përvojës së fituar në shkollë.

Grupet lëndore, të drejtuara nga specialistët e AKP-së, vlerësuan ato njohuri dhe aftësi që i gjykuan si më të rëndësishmet e që ndikojnë në shkollimin e mëtejshëm të nxënësve. Mbështetur në programet e lëndëve: gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre, për klasat respektive, u përcaktuan objektivat e vlerësimit dhe tabela e specifikimit (Blu printi) të testit.

Vlerësimi në matematikë mati njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në matematikë dhe aftësitë e tyre për të zbatuar njohuritë në zgjidhjen problemore të situatave.

Në secilën klasë nxënësit iu përgjigjën pyetjeve me alternativa dhe pyetjeve të hapura, të hartuara për të matur se çfarë dinë dhe janë në gjendje të bëjnë në këto linja:

- **Numri**
- **Ekuacione**
- **Situata problemore**

Vlerësimi në gjuhën shqipe mati aftësitë e nxënësve mbi mënyrën se si e kuptojnë një pjesë leximi, duke iu kërkuar ta lexonin atë dhe t'i përgjigjeshin pyetjeve rreth saj. Gjithashtu, ky vlerësimi mati edhe aftësitë e tyre në gjuhë dhe në të shkruar. Në secilën klasë nxënësit iu përgjigjën pyetjeve me alternativa dhe pyetjeve të hapura, të ndërtruara për të matur aftësitë e tyre në linjat e dhëna më poshtë:

- **Të lexuarit**
- **Të shkruarit**
- **Njohuri gjuhësore**

Vlerësimi në dituri natyre mati aftësitë e nxënësve në këto linja:

- **Lëndët dhe vetitë e tyre**
- **Mjedisi fizik**
- **Gjallesat dhe proceset e jetës**

Kompozimi dhe ndërtimi i testit

Vlerësimi kombëtar për klasën e 3^{-të} dhe të 5^{-të} u realizua përmes një testi të vetëm, i cili përbëhej nga 33 kërkesa (për të tri lëndët) për klasë e 3^{-të} dhe 28 kërkesa për klasën e 5^{-të}, me një kohë të përgjithshme administrimi prej 50 minutash.

Programi i vlerësimit përfshiu ato objektiva që duhet të jenë realizuar për periudhën shtator-prill 2013-2014 dhe përpara saj.

E gjithë procedura e kryer është si më poshtë:

- **Përzgjedhja e objektivave të testimit (nga programi i klasës së 3^{-të} dhe të 5^{-të});**
- **Përcaktimi i peshave të objektivave (bazuar në programin e klasës së 3^{-të} dhe të 5^{-të});**
- **Përcaktimi i niveleve të taksonomisë;**
- **Grupimi i objektivave sipas niveleve të taksonomisë;**
- **Përfshirja në çdo nivel të taksonomisë të njohurive, të aftësive intelektuale që lidhen me to dhe aftësive për t'i zbatuar njohuritë e marra, për të pasur demonstrim të kompetencave në këtë nivel (gjë që ishte dhe një ndër objektivat e testimit);**
- **Hartimi i tabelës së specifikimeve;**
- **Hartimi i pyetjeve të testit;**
- **Përgatitja e skemës së vlerësimit.**

Arritjet e nxënësve (në testin e kombinuar)

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të shpërndarjes së arritjeve, u përcaktuan 6 nivele të ndryshme për testin e kombinuar, sipas shkallëzimit të mëposhtëm. Kështu, rezultatet përmbledhen sipas 6 niveleve të aftësisë, nga niveli më i ulët tek niveli më i lartë i zotësisë që kanë treguar nxënësit në test.

Kjo ndarje është bërë në përputhje me sistemin e pikëzimit që përdoret shpesh tek ne për vlerësimin e nxënësit dhe për t'u bërë më e kuptueshme nga opinioni i gjerë dhe organizmat vendimmarrëse.

Klasa 3

	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6	
Pikë	0-10	11-17	18-24	25-31	32-38	39-45	46-50	50
Nota	4	5	6	7	8	9	10	
Nr. nx	131	142	212	283	107	97	90	32
%	12.34%	13.37%	19.96%	26.65%	10.08%	9.13%	8.47%	3.01%

Më poshtë po paraqesim disa nga arritjet në nivel kombëtar:

- **Kalueshmëria: 87.66%**
- **Koeficienti i besueshmërisë: 0.69 (i mirë)**
- **Përqindja më e madhe është përqendruar në intervalin 11- 38 pikë, ndërkohë që totali i pikëve ishte 50 pikë.**
 - **Nota 5-6: 33.33%**
 - **Nota 7-8: 46.61**
 - **Nota 9-10: 17.61**
 - **Nota 10: 30.1**
- **Niveli kombëtar i arritjes është mbi mesatar. Nxënësit e klasës së 3^{të} janë në gjendje që mesatarisht të zgjidhin më shumë se gjysmën e kërkesave të testit.**
- **Nxënësit e qytetit kanë arritje thujtë të njëjta me ata të fshatit.**
- **Vajzat kanë arritje pak më të larta se djemtë.**
- **Shkollat private kanë arritje më të larta se ato publiket.**
- **Mesataren më të lartë të pikëve e ka Gramshi, Devolli dhe Gjirokastra.**
- **DAR/ZA-të që janë me pikë nën mesataren e vendit janë Bulqizë, Kurbin.**
- **Numrin më të madh të nxënësve pjesëmarrës e ka Tirana Qytet.**

Klasa 5

	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6	
Pikë	0-10	11-17	18-24	25-31	32-38	39-45	46-50	50
Nota	4	5	6	7	8	9	10	
Nr. nx	172	141	172	262	247	124	173	86
%	13.32%	10.92%	13.32%	20.29%	19.13%	9.60%	13.40%	6.66%

- **Kalueshmëria: 86.68%**
- **Koeficienti i besueshmërisë: 0.69 (i mirë)**
- **Përqindja më e madhe është përqendruar në intervalin 13.8- 29.5 pikë, ndërkohë që totali i pikëve ishte 35 pikë.**
 - **Nota 5-6: 24.24%**
 - **Nota 7-8: 39.43%**
 - **Nota 9-10: 23.01%**
 - **Nota 10: 6.66%**
- **Niveli kombëtar i arritjes është mbi mesatar. Nxënësit e klasës së 5^{-të} janë në gjendje që mesatarisht të zgjidhin më shumë se gjysmën e kërkesave të testit.**
- **Nxënësit e qytetit kanë arritje thujse të njëjta me ata të fshatit.**
- **Vajzat kanë arritje pak më të larta se djemtë.**
- **Shkollat private kanë arritje më të larta se ato publiket.**
- **Mesataren më të lartë të pikëve e ka Gjirokastra, Pogradeci dhe Shkodra.**
- **DAR/ZA-të që janë me pikë nën mesataren e vendit janë Bulqiza, Hasi, Kruja, Kurbini, Mati, Puka, Tepelena, Skrapari, Berati dhe Dibra.**
- **Numrin më të madh të nxënësve pjesëmarrës e ka Tirana Qytet.**

Gjetjet

Nga analiza e treguesve u vu re se nxënësit janë të aftë:

- të dallojnë fjalinë, llojet e saj, krijojnë fali, të identifikojnë informacioni e duhur në tekst, të gjejnë cilësi të personazheve, të gjejnë kryefjalën.
- të kryejnë veprime, mbledhje –zbritje, shumëzim, rumbullakosin dhe shkruajnë numrat me fjalë.
- të dallojnë njësitë bazë të matjeve, të dallojnë objektet në varësi të lëndës që i përbën ata.

Nxënësit shfaqën vështirësi:

- në arsyetime, ekuacionin, pjesëtimin dhe mënyrën si e strukturojnë gjetjen e zgjidhjes së problemës, shtrimin e problemës me 2-3 veprime. Rreth 63% e nxënësve pothuajse nuk e kanë zgjidhur problemin.
- në dhënien e përfundimeve, gjetjen e mesazhit të pjesës, një mbyllje ndryshe të fragmentit letrar të dhënë si dhe dallimin e gjinisë letrare.
- në rubrikën *Të shkruajmë*. Kjo është një nga pyetjet, kur në të dy klasat (3 dhe 5) nxënësit shfaqën probleme serioze.

Për klasën e 3^{-të}:

- 24.11%** e popullatës nuk ka shkruar asgjë në lidhje me pyetjen e hapur (ese) ose ideja që ata janë përpjekur të komunikojnë ka qenë e paqartë për të marrë pikë.
- 31.17%** e nxënësve kanë marrë vetëm 1 pikë në këtyre pyetje, që do të thotë se tek ata vihet re një përpjekje minimale për të dhënë një ide, gjë që vihet re edhe në paqartësinë e asaj që duan të shprehin, janë të paorganizuar dhe teksti i shkruar përmban shumë gabime drejtshkrimore apo i përdorin gabim shenjat e pikësimit.
- Vetëm **21.66%** e tyre kanë marrë pikët maksimale për këtë pyetje. Shifra është e ulët, po të kemi parasysh se qëllimi i lëndës së gjuhës shqipe është që t'i aftësojë nxënësit të formojnë dhe të shprehin idetë e tyre në lidhje me tema të caktuara dhe jo thjesht të mbartin disa aftësi mekanike që shfaqen vetëm në zgjidhje ushtrimesh, sipas një mënyre të mësuar përmendësh.
- 27 %** e nxënësve (*në matematikë*) nuk dinë të shkruajnë numërorët e dhënë me fjalë dhe anasjelltas.
- Dobësi paraqesin nxënësit në zgjidhjen e ekuacioneve e inekuacioneve si dhe veprimet me shumëfishat e numrave (**28 %** e tyre nuk marrin asnjë pikë).
- Dobësi akoma më të mëdha paraqesin në njohuritë gjeometrike dhe në zgjidhjen e problemave (Rreth 30% e tyre nuk dinë të veprojnë fare). Problemin vetëm 17% e tyre dinë ta zgjidhin plotësisht.
- 17% e nxënësve i përgjigjen sakt, *në diturinë e natyrës*, pyetjes që analizon lidhjen midis fërkimit dhe lëvizjes.

Për klasën e 5^{-të}:

- 33.95%** e nxënësve kanë marrë 0 pikë (pyetja ese), pra ata nuk i janë përgjigjur pyetjes ose përpjekja e bërë ka rezultuar e gabuar.
- Ndërkohë **17.54%** e nxënësve kanë marrë 1 pikë, gjë që dëshmon për një përpjekje minimale për t'iu përgjigjur kërkesës.
- Nxënësit që kanë marrë 2 pikë (**15.84%**) japin një mbyllje tjetër të pjesës që iu është dhënë, janë më të qartë në idenë që shprehin, e cila lidhet natyrshëm me përmbajtjen e pjesës dhe është një mbyllje logjike, por bëjnë disa gabime qoftë të shprehjes ose edhe drejtshkrimore.
- Vetëm **24.36%** e nxënësve kanë marrë pikët maksimale për këtë pyetje, pra shkruajnë një përgjigje të strukturuar qartë në paragrafë (dy-tri paragrafë), me lidhje të natyrshme midis tyre dhe vijueshmëri mendimi, përdorin fjali që variojnë në gjatësi dhe strukturë. Përgjigjja e dhënë ka shumë pak ose aspak gabime drejtshkrimore.

- 32 %** e nxënësve (*në matematikë*) nuk dinë të shkruajnë numrorët e dhënë me fjalë.
- gati gjysma e nxënësve nuk dinë të kryejnë veprime matematike.
- 43%** e nxënësve nuk dinë të bëjnë rumbullakimin e numrave të plotë.
- 43%** e nxënësve nuk dinë të zgjidhin ekuacionin.
- 45%** e nxënësve dinë të kryejnë saktë veprimet me numra dhjetorë.
- 51 %** e nxënësve dinë të kryejnë saktë veprimet me thyesa.
- Shqetësues mbetet përvetësimi i njohurive gjeometrike ku **45%** e nxënësve marrin 0 pikë.
- Dobësi të theksuara nxënësit kanë në zgjidhjen e problemit ku vetëm **27%** e tyre arrijnë të veprojnë.
- Në diturinë e natyrës*, nxënësit paraqesin vështirësi në pyetjet e hapura, ku duhet të shkruajnë apo të japin argumente. Vetëm **11%** e tyre kanë marrë pikët e plota (pyetja 6), kur iu kërkohet të gjejnë funksionet kryesore të dy pjesëve të qelizës.

Faktorët që mund të kenë ndikuar në këto rezultate:

- 1.** Ekzistenca e niveleve të ndryshme të cilësisë në mësimdhënie gjatë procesit mësimor, kjo më e dallueshme mes qytetit dhe fshatit, si dhe mes sistemit publik dhe atij privat.
- 2.** Ekzistenca e niveleve të ndryshme të cilësisë dhe kualifikimit të mësuesve në nivel kombëtar, por edhe mes sistemit privat dhe atij publik, qytetit dhe fshatit;
- 3.** Cilësia jo e lartë e teksteve bazë për nxënësit;
- 4.** Të mësuarit sistematik nga vajzat ka sjellë që ato të kenë rezultate më të larta se djemtë;
- 5.** Fiktiviteti në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor;
 - mungesa e kriterëve kombëtarë të vlerësimit në shkollë, të qarta dhe të sakta, ka sjellë pështjellim në vlerësimin me notë të nxënësve;
- 6.** Niveli social – ekonomik i familjeve dhe komuniteteve përkatëse ku jetojnë nxënësit.

Përfundime

7. Përqindja e nxënësve me 0 dhe 1 pikë (nga 3 pikë të që ka pyetja) në rubrikën *të shkruajmë* është mjaft e lartë (më shumë se gjysma e popullatës së testuar).

Mendojmë se arsyet lidhen:

- me punën e pamjaftueshme që zhvillohet me ta në drejtim të të shkruarit dhe të lexuarit. Të dyja këto kompetenca të gjuhës jepen në mënyrë thujse të ndarë në tekstet shkollore (madje në orë të veçanta edhe pse programi thekson integrimin midis tyre) dhe në të njëjtën mënyrë u mësohen nxënësve edhe nga ana e mësuesve. Fjalori i varfër që bie në sy, mungesa e vijueshmërisë së mendimit kur përshkruajnë, paaftësia për të gjetur një alternativë tjetër për mbylljen e një tregimi, gabime të shumta në drejtshkrim, shenja pikësimi dhe shkronjë e madhe, lidhen ngushtësisht edhe me leximin e pakët që nxënësit bëjnë jashtë shkollës.
8. Mungesa e zhvillimit të kompetencës së të lexuarit, që vihet re në testin e gjuhës shqipe, është e dukshme edhe në testin e matematikës, pasi nxënësit nuk lexojnë mirë kërkesat e pyetjes. Kjo shfaqet në zgjidhjen e problemës, në hartimin e pyetjeve dhe nxjerrjen e përfundimit të saj.
9. Nxënësit orientohen më shumë në të mësuarit përmendësh se sa në formimin e kompetencave.
10. Rezultatet kontradiktore në disa pyetje të testit, lënë shteg për ngritjen e dyshimit se nuk janë zbatuar me përpikëri rregullat e administrimit (gjatë korrigjimit të testeve u vunë re përgjigje të dhëna njësoj në pyetjet e hapura).
11. Mungesa e koherencës midis linjave të programit lëndor dhe teksteve të shumta alternative, si dhe përdorimi i termave të ndryshme për të njëjtin koncept në tekste të ndryshme në gjuhën shqipe dhe në matematikë, ka sjellë vështirësi për ndërtimin e një testi që përfshin të gjitha linjat e programit, pa penalizuar nxënësit.
12. Shumë nga dobësitë e nxënësve, të vërejtura nga analiza e të dhënave, e kanë burimin te mësimdhënia që zbatohet në shkollë, e cila synon të vërë theksin tek njohuritë dhe aftësitë e testuara dhe jo në të gjitha objektivat e shpallura në kurrikul. **Për këtë arsye ka:**
- një devijimin, deri në një farë shkalle, nga kurrikula e synuar (mësuesit përqendrohen më shumë në arritjen e objektivit minimal dhe nuk shkojnë më tej).
 - një vështirësi në përdorimin e formave bashkëkohore më të përparura të vlerësimit, të cilat synojnë të vlerësojnë përdorimin e njohurive që nxënësit kanë fituar në shkollë.

Rekomandime

- 1.** Administrim më i fortë i procesit të testimit.
- 2.** Të dhënat e studimit kanë nxjerrë në pah mungesën e standardeve lëndore. Rezultatet e provimeve kombëtare dhe kryerja e vlerësimeve kombëtare në mënyrë ciklike do të mundësojnë vlerësimin e kurrikulave dhe të standardeve lëndore të hartuara nga specialistët e IZHA-së. Ato do t'u mundësojnë institucioneve përgjegjëse për të lidhur më mirë trajnimin e mësuesve me kërkesat e kurrikulës si dhe të vlerësimit të nxënësve.
- 3.** Të shtohen orët e drejtshkrimit në lëndën e gjuhë shqipe (mësuesi mund të përdorë orët 1/3).
- 4.** AKP duhet të hartojë një plan strategjik për trajnimin e mësuesve për teknikat e vlerësimit të nxënësve në klasë.

PJESA II

Si u realizua vlerësimi

Vlerësimi i njohurive dhe i aftësive të nxënësve u realizua me test të tipit laps-letër, me një shkallë të konsiderueshme besueshmërie, vlefshmërie dhe objektiviteti. Testi ishte në format të shtypur dhe nxënësit e shkruan në të përgjigjen e tyre. Pyetjet ishin të tipave dhe formateve të ndryshëm. Koha e testimit ishte 50 min, testi përmbante 19 pyetje me një total prej 35 pikësh.

Testimi u realizua në mjedise ku mësojnë nxënësit. Testi u administrua nga administratorët e testit, të cilët u trajnuan përpara testimit. Në përfundim të procesit, të gjitha testet i grumbulluan në mjediset e AKP-së. Më pas ato u vlerësuan nga mësues të ciklit fillor, për rreth një javë. Të gjithë vlerësuesit u trajnuan nga specialistët e AKP-së, përpara procesit të korrigjimit.

Përcaktimi i kampionit

Kampioni i nxënësve për këtë vlerësim kombëtar të klasave të treta dhe të pesta u krijua duke bërë një përzgjedhje në bazë të teorive statistikore, në mënyrë që rezultatet e marra nga ky vlerësim, të jenë të vlefshme për të treguar arritjet e nxënësve si dhe tregues të tjerë të pjesëve përbëre të sistemit arsimor.

Hapat kryesore neper te cilat kaloi përzgjedhja e kampionit ishin:

1. Përcaktimi i popullatës së studimit dhe modelit të zgjedhjes së kampionit;
2. Grumbullimi, organizimi dhe përpunimi i statistikave të nevojshme për zgjedhjen e kampionit;
3. Përcaktimi i kampionit të shkollave;
4. Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për testim.

Në këtë studim janë përfshirë të gjithë nxënësit e klasës së treta dhe klasës së peste. Nga popullata e dëshiruar janë lënë jashtë studimit nxënësit e shkollave me më pak se gjashtë nxënës në klasën e tretë dhe klasën e pestë. Gjithashtu, në studim janë përfshirë vetëm nxënësit e shkollave klasike. Meqenëse shkollat me më pak se gjashtë nxënës, përbejnë më pak se 5% të popullatës, atëherë mospërfshirja e tyre nuk sjell ndonjë deformim të rezultateve përfundimtare.

Bazuar në teorinë statistikore, masa e kampionit në fazën e dytë u përcaktua të ishte më e vogël se në fazën e parë. Kështu, në fazën e dytë, masa e kampionit ishte 1173 nxënës në klasën e tretë, nga të cilët morën pjesë në testim 1062 nxënës (111 nxënës munguan), dhe 1408 nxënës në klasën e pestë, nga të cilët morën pjesë në testim 1291 nxënës (117 nxënës munguan). Ky numër nxënësish përben rreth 3% të të gjithë nxënësve që mësojnë përkatësisht në klasë e tretë dhe në klasën e pestë, në të gjithë vendin. Rrjedhimisht, në testim u përfshinë rreth 100 shkolla nga i gjithë vendi.

Për të formuar kampionin e kërkuar, u përcaktua që numri i nxënësve për testim nga çdo shkollë, të ishte 35 nxënës për shkollat me numër të madh nxënësish dhe i gjithë numri i nxënësve për shkollat që kishin më pak se 35 nxënës në klasën e tretë apo në klasën e pestë.

Modeli i përzgjedhjes së kampionit ishte modeli proporcional. Se pari, zgjidhen shkollat e kampionit duke ruajtur peshën, përqindjen që zë secila shkollë në popullatë. Me tej behet zgjedhja e nxënësve për testim nga çdo shkollë e përzgjedhur. Formimi i kampionit me këtë metodë bëhet i kombinuar: me metodën me shtresëzim dhe atë me clastera. Ky model bën të mundur një përfaqësim të mirë të të gjithë popullatës dhe nuk ka kosto të tepruara për realizimin e tij.

Përpunimi i statistikave te nevojshme

Nga baza e të dhënave për regjistrimet e vitit shkollor 2013-2014, arsimit i detyruar, u identifikuan shkollat target, që kishin nxënës në klasën e tretë dhe në klasën e pestë.

Popullata e konsideruar për klasën e trete ishte 34740 nxënës dhe ishte e shpërndarë në 1223 shkolla.

Për klasën e pestë kjo popullate ishte 39664 nxënës, të shpërndarë në 1297 shkolla, në të gjithë vendin.

Nga kjo bazë të dhënash, u përzgjedhën 116 shkolla për klasën e tretë dhe 139 shkolla për klasën e pestë.

Meqenëse modeli i përzgjedhjes ishte proporcional u ruajtën peshat për çdo ndarje të popullatës: prefekturë, DAR/ZA, qytet/fshat, publike/jopublike.

Përcaktimi i kampionit te shkollave

Shkollat u përzgjedhën duke bërë që në fillim grupimin e shkollave me numër nxënësish mbi 35 dhe nën 35.

Kështu, për **klasën e tretë** kishim:

1. 318 shkolla me mbi 35 nxënës në klasën e tretë dhe këto kishin 60% të nxënësve të të gjithë popullatës
2. 905 shkolla me më pak se 35 nxënës në klasën e tretë, që përfshinin 40% të nxënësve të të gjithë popullatës.

Për klasën e pestë:

1. 375 shkolla me mbi 35 nxënës në klasë e pestë dhe këto kishin 64% të nxënësve të të gjithë popullatës
2. 922 shkolla me më pak se 35 nxënës në klasën e pestë, që përfshinin 36% te nxënësve të të gjithë popullatës

Për secilin grup u be ndarja në shkolla qyteti dhe shkolla që gjenden në fshat dhe, me tej, ndarja tjetër në shkolla publike dhe jopublike. Është e rëndësishme të vihet në dukje se, për çdo shkolle u llogaritën dhe u ruajtën peshat përkatëse për të siguruar një vlerësim më të saktë të statistikave përfundimtare të popullatës.

Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për testim

Pas zgjedhjes së kampionit të shkollave, u kërkuar nga secila shkollë lista e plotë elektronike e nxënësve që mësonin në klasën e tretë dhe në klasën e pestë. Këto lista u pastruan nga dublikatat e emrave dhe gabime të tjera që ishin bërë gjatë informatizimit.

Me pas u zbatua procedura e përzgjedhjes së 35 nxënësve me probabilitet të njëjtë për secilën nga shkollat e kampionit me më shumë se 35 nxënës. Për shkollat e tjera u përzgjedhën të gjithë nxënësit.

Pas përzgjedhjes së nxënësve u bë kodimi i tyre, me një kod, i cili ishte unik për çdo nxënës. Ky kod përmbante informacion në lidhje me DAR/ZA dhe shkollën ku mësonte nxënësi.

Ky kod u përdor për të sekretuar testin e çdo nxënësi dhe me tej ishte çelësi kryesor për lidhjen e të dhënave të nxënësit me ato të shkollës.

Pas kodimit, u përgatiten për çdo shkollë, listat e nxënësve që do të përfshiheshin në testim. Këto lista u dërguan bashke me testet në çdo shkollë të kampionit.

Administrimi i testit dhe të dhënave

Për të siguruar një proces korrekt, u kërkuar nga çdo DAR/ZA të caktohej një koordinator rajonal dhe një administrator testi për çdo klasë që do të testoheshin.

Koordinatorët u trajnuan në AKP për procesin që do të administroheshin. Ata me tej do të trajnonin administratorët e testit. Kështu u trajnuan 38 koordinatorë dhe rreth 200 administratorë në të gjitha shkollat e përzgjedhura.

Pas shumëfishimit të testeve, ato bashke me listat emërore të koduara për çdo shkollë, u paketuan në qese DHL dhe u shpërndanë 1 ditë para testimit në çdo DAR/ZA.

Ditën e testimit u ofrua asistencë për paqartësitë dhe problemet që hasnin administratorët. Vetëm në një shkollë nuk u zhvillua testimi, për shkak të kushteve të vështira të motit.

Pas përfundimit të testimit, testet dhe listat emërore të plotësuara me shënimet përkatëse, u dorëzuan në AKP, ku u administruan dhe u informatizuan.

Pas informatizimit të rezultateve u bë lidhja e tyre në bazë të kodit të nxënësit (barkodit) me bazën e të dhënave të shkollave dhe filloi studimi i statistikor i tyre.

KLASA III

TESTI I GJUHËS SHQIPE

Programi dhe struktura e testit në gjuhën shqipe

Për hartimin e kërkesave të testit të gjuhës shqipe punoi një grup i përbërë nga mësues të ciklit të ulët dhe specialistë lëndorë të vlerësimit.

Vlerësimi i nxënësve në gjuhën shqipe përmbante një shumëllojshmëri kërkesash. Programi i vlerësimit përfshiu ata objektiva që duhet të jenë realizuar për periudhën shtator 2013-prill 2014. e gjithë procedura e kryer është si më poshtë:

- **Përzgjedhja e objektivave kryesorë të testit (nga programi i klasës 3^{të});**
- **Përcaktimi i peshave të objektivave (bazuar në programin e gjuhës shqipe, kl. 3^{të});**
- **Përcaktimi i niveleve të taksonomisë;**
- **Grupimi i objektivave sipas niveleve të taksonomisë;**
- **Hartimi i tabelës së specifikimeve;**
- **Hartimi i pyetjeve të testit;**
- **Përgatitja e skemës së vlerësimit.**

Tabela 1 (tabela e specifikimeve) ilustron linjat dhe nënlinjat si dhe përqindjet që i takojnë çdo linje. Ndarja është bërë për qartësimin e aftësive që zotëron nxënësi dhe vlerësimin e tyre. Njëkohësisht është mbajtur parasysh se ato janë mësuar të integruara me njëra-tjetrën dhe shpesh janë parë të tilla edhe në kërkesat e testit.

Linjat/objektivat	Pesha	Pikët	Njohja/Kup	Zbatimi	Analiza/Sinteza
I. Të lexuarit <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë detaje shtesë rreth informacionit. • të zgjerojë me detaje shtesë informacionin e marrë nga burime të ndryshme. • të rendisë pikat e planit. • të identifikojë mesazhin e pjesës që lexon. • të analizojë personazhin kryesor. • të identifikojnë llojin e pjesës; • të analizojë personazhin kryesor. 	51%	8	3	3	2
II. Të shkruarit <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë tregime të shkurtra, orientuar nga figura. 	14%	3	1	1	1
III. Njohuri gjuhësore <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalinë dëftore, pyetëse dhe habitore. • të dallojë fjalinë pohore dhe mohore. • të shtojë dhe të heqë fjalë në një fjali të thjeshtë pa prishur kuptimin 	34%	9	3	4	2

e saj. të zhvendosë fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj. të dallojë grupet plotësuese në fjali. të dallojë kohën e foljes. të përdorë drejt shenjat e pikësimit					
---	--	--	--	--	--

Ndërtimi i testit dhe instrumentet e vlerësimit

Testi i gjuhës shqipe u kompozua me dy pjesë.

Pjesa e parë vlerësoi njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në lexim. Ajo përmbante një fragment leximi dhe disa pyetje që lidheshin me të.

Pjesa e dytë vlerësoi njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në gjuhën shqipe.

Pyetjet ishin të formateve të ndryshme: me zgjedhje (alternativa), me plotësim, me përgjigje të shkurtër dhe ese.

Në linjën *Të shkruajmë*, nxënësit patën edhe një material ndihmës, një figurë. Duke u bazuar në të, atyre iu kërkua të krijonin një histori të shkurtër.

Testi u shoqërua me një skemë pikëzimi, si ndihmë për vlerësuesit, ku u detajua përgjigjja e mundshme që nxënësi mund të jepte për çdo kërkesë.

Arritjet e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe

Më poshtë do të paraqesim një përshkrim dhe portretizim të arritjeve të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe, shpërndarjen e arritjeve sipas niveleve të ndryshme, çfarë janë në gjendje të bëjnë nxënësit e niveleve të ndryshme dhe disa nga gjetjet interesante që dolën nga analiza e të dhënave.

Për të pasur të dhëna krahasuese, nxënësit u kategorizuan sipas katër niveleve të arritjeve, si në tabelën më poshtë.

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Shumë mirë)
Pikët	0-5 pikë	6-11 pikë	12-16 pikë	17-20 pikë
Nr. i nxënësve	153	417	268	224
%	14.40%	39.26%	25.23%	21.09%

Tabela 1

- Totali i nxënësve pjesëmarrës: 1062
- 96 nxënës kanë marrë pikët maksimale, 20 pikë.
- Numri më i madh i nxënësve është përqendruar në intervalin 6-11 pikë, që i takon nivelit mjaftueshëm.

Përshkrimet e niveleve

Niveli 0: në të bëjnë pjesë nxënësit që nuk kanë arritje të mjaftueshme për t'u quajtur kalues.

Niveli 1: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë njohuritë dhe shprehjet elementare të lëndës së gjuhës shqipe, p.sh: të identifikojnë fjalinë pyetëse, fjalinë pohore dhe mohore, të dallojë kohën e foljes, të identifikojë llojin e pjesës, të tregojë se e kupton përmbajtjen e pjesës.

Shembull pyetjeje i këtij niveli:

Pyetja 2a (90.46%)

Kjo histori është një:

Fabul tregim përrallë vjershë

Objektivi: të identifikojnë llojin e pjesës.

Procesi: Njohja dhe të kuptuarit

Niveli 2: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë të gjitha aftësitë që zotërojnë nxënësit e nivelit të parë, por nga ana tjetër ata shfaqin edhe një sërë aftësisht më të larta si: të shtojë dhe të heqë fjalë në një fjali të thjeshtë pa prishur kuptimin e saj të analizojnë personazhin kryesor, të shkruajnë mesazhin e pjesës që lexuan, të krijojnë një histori bazuar në një figurë, etj.

Shembull pyetjeje i këtij niveli:

Pyetja 7 (42.07%)

Zgjeroni me dy grupe plotësuese fjalinë:

Era frynte fort: _____

Objektivi: Të shtojë dhe të heqë fjalë në një fjali pa e prishur kuptimin e saj.

Procesi: Zbatimi dhe analiza

Niveli 3: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë aftësi të larta për të shkruar një tekst të organizuar mirë, qartë dhe pa gabime. Ata njohin qartë njohuritë dhe konceptet gjuhësore.

Shembull pyetjeje i këtij niveli:

Pyetja 9 (20.80%)

Krijoni një histori të shkurtër, bazuar në figurën e mëposhtme.

Objektivi: të shkruajë tregime të shkurtra, orientuar nga figura.

Procesi: Reflektim dhe përgjigje personale

Në tabelën 2 jepen përqindjet e nxënësve që dhanë përgjigje të sakta për secilën prej pyetjeve të gjuhës shqipe (testi me pyetjet është në fund të materialit).

	P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P10	P11	P 12	P 13	P14	P 15	P 16	P 17
0	5.71%	18.58 %	15.00 %	15.86 %	43.48 %	34.59 %	18.58 %	23.96 %	53.71 %	11.00 %	43.14 %	30.52 %	39.05 %	30.35 %	23.79 %	38.62 %	21.82 %
1	84.83 %	71.95 %	75.53 %	74.68 %	47.06 %	30.50 %	71.95 %	66.58 %	36.83 %	79.54 %	47.40 %	36.23 %	51.49 %	60.19 %	66.75 %	51.92 %	28.22 %
2	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	23.79 %	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	20.89 %
3	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	19.61 %

Tabela 2

Nëse do t'i referoheshim **pyetjes 17**, e cila kërkon që ata të krijojnë një histori të shkurtër bazuar në një figurë, vëmë re se 21.82% e popullatës nuk ka shkruar asgjë në lidhje me këtë pyetje ose ideja ka qenë e paqartë për të marrë pikë. Ndërkohë 28.22% e nxënësve kanë marrë vetëm 1 pikë, që do të thotë se tek ata vihet re një përpjekje minimale për të komunikuar një ide, por nuk kanë arritur ta realizojnë këtë, kanë shkruar një ose dy fjali, por ta paqarta dhe ta palidhura me njëra-tjetrën dhe me shumë gabime drejtshkrimore apo shenja pikësimi. Vetëm 19.69% e tyre kanë marrë pikët maksimale për këtë pyetje. Shifra është e ulët, po të kemi parasysh se qëllimi i lëndës së gjuhës shqipe është që t'i aftësojë nxënësit të shprehën dhe shkruajnë idetë e tyre në lidhje me tema të caktuara dhe jo thjesht të mbartin disa aftësi mekanike që shfaqen vetëm në zgjidhje fragmentare ushtrimesh.

Në figurën 3 dhe 4 janë dhënë mesatarja kombëtare e arritjes dhe gabimi standard.

Rastet					
Të përfshirë		Mungesa		Total	
N	Përqindja	N	Përqindja	N	Përqindja
1062	90.5%	111	9.5%	1173	100.0%

Tabela 3

N	Mesatarja	Mediani	Gabimi standard i mesatare	Devijimi Standard	Varianca
1062	11.36	11.00	0.061	3.327	11.070

Tabela 4

Pjesëmarrja në testim është 90.5 % ndërsa përqindja e mungesave 9.5 %.

Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 11.36.

Vlera e mesme e arritjeve është 11.00.

Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.061.

Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të

madh vlerash. Në rastin tonë devijim standard 3.327 tregon se shumica e nxënësve kanë marrë pikët në intervalin 6 deri në 17.

Histogrami i fig. 5 jep vizualisht një ide më të qartë të shpërndarjes së arritjeve kombëtare në gjuhën shqipe.




Fig. 5

Arritja mesatare kombëtare në lëndën e gjuhës shqipe është 11.36%. Gabimi standard i vlerësuar është 0.061.

Përfundimet e mësipërme u nxorën nga kampioni i nxënësve që dhanë testin e gjuhës shqipe prej 1062 vetash, të cilët përfaqësuan të gjithë popullatën e nxënësve të klasës së tretë në Shqipëri.

Arritjet sipas ciklit të shkollave

Qytet apo fshat	Nr i nx	Mesatare	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi Standard	Varianca
Fshat	464	11.11	11.00	.095	3.307	10.934
Qytet	598	10.76	12.00	.078	3.320	11.024
Total	1062					

Tabela 6

Në tabelën 6 ju do të gjeni arritjet kombëtare sipas lokalitetit të shkollave.

Vëmë re se nxënësit e fshatit kanë një diferencë të vogël nga ata të qytetit.

Arritjet e nxënësve sipas ciklit të shkollave

Lloji sipas ciklit	Nr i nx	Mesatare	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi Standard	Varianca
9VJ	776	11.11	11.00	.067	3.267	10.672
BM	164	10.46	11.00	.157	3.433	11.784
CU	122	10.45	11.00	.290	3.823	14.619
Total	1062					

Tabela 7

Nga tabela 7 vëmë re se arritjet e nxënësve në shkollat 9-vjeçare janë pak më të larta, krahasuar me ato të BM dhe CU.

Arritjet e nxënësve sipas gjinisë

Gjinia	Nr i nx	Mesatare	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
F	473	11.36	11.00	.083	3.121	9.741
M	589	11.41	11.00	.087	3.454	11.928
Total	1062					

Tabela 8

Nga tabela 8 vëmë re se femrat kanë arritje thuajse të njëjta me meshkujt në testin e gjuhës shqipe.

Arritjet e nxënësve sipas llojit të shkollave

Publike, Private	Nr i nx	Mesatare	Median	Gabimi standart I mesatares	Devijimi Standart	Varianca
Private	86	12.94	13.00	.136	2.021	4.083
Publike	976	10.32	11.00	.063	3.335	11.121
Total	1062					

Tabela 9

Po të analizojmë tabelën 9, vëmë rë se arritjet e nxënësve në shkollat private janë më të larta se në shkollat publike.

Pikët mesatare sipas DAR/ZA

DAR/ZA	Nr i nx	Mesatare	Median	Gabimi standard i mesatare	Devijimi Standard	Varianca
Berat	34	9.98	10.50	0.28	2.81	7.90
Bulqizë	19	7.16	7.00	0.55	3.87	14.97
Delvinë	12	10.21	11.00	0.55	3.17	10.05
Devoll	15	12.95	14.00	0.36	2.37	5.63
Dibër	32	9.19	9.00	0.30	2.83	8.02
Durrës	63	10.96	11.00	0.22	2.97	8.84
Elbasan	51	9.59	10.00	0.28	3.44	11.86
Fier	54	10.93	12.00	0.24	3.16	10.01
Gjirokastër	32	12.81	13.00	0.22	2.11	4.45
Gramsh	16	13.59	14.00	0.21	1.15	1.32
Has	18	9.23	9.50	0.75	3.50	12.28
Kamëz	21	9.56	10.00	0.38	3.16	9.98
Kavajë	21	9.95	10.00	0.42	3.70	13.72
Kolonjë	14	9.76	10.00	0.62	3.59	12.91
Korçë	24	10.93	12.00	0.33	3.26	10.66
Kruje	21	9.83	11.00	0.42	3.70	13.66
Kucovë	12	11.72	12.00	0.45	1.90	3.62
Kuçovë	18	10.57	12.00	0.71	4.18	17.49
Kukës	17	10.62	11.00	0.40	2.69	7.24
Kurbin	15	7.00	7.00	0.67	3.97	15.76
Lezhë	42	10.48	11.00	0.31	3.64	13.26
Librazhd	21	10.18	11.00	0.31	2.80	7.81
Lushnje	24	11.48	12.00	0.24	2.43	5.93
Malësi e Madhe	25	9.77	11.00	0.42	3.07	9.41
Mallakastër	16	9.74	10.00	0.54	3.21	10.31
Mat	21	8.72	9.00	0.47	3.83	14.66
Mirditë	20	9.54	10.00	0.44	3.39	11.49
Peqin	23	9.83	10.00	0.42	3.04	9.26
Përmet	19	11.69	12.00	0.40	2.36	5.57
Pogradec	27	11.25	12.00	0.32	2.89	8.34
Pukë	22	9.74	10.00	0.54	3.21	10.31
Sarandë	19	11.49	12.00	0.39	3.18	10.10
Shkodër	34	11.43	12.00	0.20	2.68	7.21
Skrapar	23	9.31	10.00	0.49	3.80	14.42
Tepelenë	24	11.34	12.00	0.44	2.99	8.93
Tiranë	38	8.70	9.00	0.35	3.53	12.43
Qark Tirane	78	12.05	13.00	0.17	2.69	7.22
Qytet Tropojë	34	8.95	8.50	0.43	2.79	7.80
Vlorë	43	10.73	11.00	0.34	3.11	9.68

Tabela 10

Në tabelë 10 janë paraqitur arritjet e nxënësve për çdo DAR\ZA.

Siç shihet dhe nga tabela:


- mesataren më të lartë të pikëve e ka Zyra Arsimore e Gramshit, Devollit, DAR- Tiranë, Përmeti, Saranda, Lushnja, Tepelena;
- mesataren më të ulët Zyra Arsimore e Kurbinit dhe Bulqiza;
- numrin më të madh të nxënësve pjesëmarrës e ka Drejtoria arsimore e Tiranës, ndërsa numrin më të vogël të pjesëmarrësve Zyra arsimore e Delvinës.

MATEMATIKË

Shpërndarja e pikëve të testit

Pikë	0-5	6-8	9-11	12-14	15-16	17-18	19-20	20
Nota	4	5	6	7	8	9	10	
Nr nx	123	244	215	124	131	89	136	46

- Kalueshmëria: 88%
- Nota 10: 4,33%
- Nota 9-10: 21,18%
- Nota 7-8: 24%
- Nota 5-6: 43,22%
- Nota mesatare 6.5



Grafiku i mësipërm paraqet shpërndarjen e pikëve për pyetjet e matematikës

	Pyetja 1	Pyetja 2	Pyetja 3	Pyetja 4	Pyetja 5	Pyetja 6	Pyetja 7	Pyetja 8	Pyetja 9
Mungesa	9,46%	9,46%	9,46%	9,46%	9,46%	9,46%	9,46%	9,46%	9,46%
0 pikë	27,37%	23,10%	24,38%	38,45%	10,91%	27,96%	27,28%	32,23%	26,85%
1 pikë	63,17%	67,43%	21,57%	52,09%	28,22%	27,37%	25,32%	36,23%	30,86%
2 pikë	0,00%	0,00%	44,59%	0,00%	19,18%	19,52%	16,88%	22,08%	15,09%
3 pikë	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	15,17%	15,69%	21,06%	0,00%	17,73%
4 pikë	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	17,05%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
5 pikë	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%

- 27 % e nxënësve nuk dinë të shkruajnë numërorët e dhënë me fjalë dhe anasjelltas.
- Dobësi paraqesin nxënësit në zgjidhjen e ekuacioneve e inekuacioneve si dhe veprimet me shumëfishat e numurave (28 % e tyre nuk marrin asnjë pikë).
- Dobësi akoma më të mëdha paraqesin në njohuritë gjeometrike dhe në zgjidhjen e problemave Rreth 30% e tyre nuk dinë të veprojnë fare. Problemin vetëm 17% e tyre dinë ta zgjidhin plotësisht.

Mesatarja kombëtare e arritjes, gabimi standard

Rastet					
Të paraqitur		Mungesa		Total	
Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja
1062	90,5%	111	9,5%	1173	100,0%

- Pjesëmarrja në testim është 90.5 % ndërsa përqindja e mungesave 9.5 %;
- Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 10.69;
- Vlëra e mesme e arritjeve është 11.00.

Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.054

Devijimi standard është masa e variacionit ose shpërhapjes së të dhënave apo shpërndarjes së probabilitetit.

Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
1062	10,69	11,00	0,054	2,936	8,621

Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash.

Në rastin tonë devijim standard 2.936 tregon se shumica e nxënësve kanë marrë pikët në intervalin 5 deri në 14.

Mesatarja e pikëve për nxënës është 10,69.

Pikët mesatare sipas DAR\ZA

DAR/ZA	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Berat	34	9,90	10,50	0,332	3,317	11,000
Bulqizë	19	9,27	10,00	0,514	3,598	12,949
Delvinë	12	10,18	10,00	0,516	2,963	8,778
Devoll	15	12,32	12,50	0,399	2,648	7,013
Dibër	32	10,35	10,00	0,253	2,415	5,831
Durrës	63	11,08	11,00	0,207	2,736	7,488
Elbasan	51	9,80	10,00	0,210	2,586	6,689
Fier	54	11,11	11,00	0,246	3,202	10,254
Gjirokastër	32	12,13	12,00	0,206	1,956	3,825
Gramsh	16	11,97	12,00	0,349	1,880	3,534
Has	18	9,59	9,50	0,486	2,282	5,206
Kamëz	21	9,72	10,00	0,347	2,859	8,174
Kavajë	21	10,44	11,00	0,332	2,968	8,806
Kolonjë	14	10,77	11,00	0,487	2,881	8,299
Korçë	24	11,22	11,00	0,290	2,840	8,067
Kruje	21	10,08	10,00	0,319	2,780	7,727
Kucovë	12	11,28	12,00	0,620	2,630	6,918
Kuçovë	18	10,34	11,00	0,677	4,007	16,055
Kukës	17	11,31	11,00	0,280	1,881	3,537
Kurbin	15	8,09	10,00	0,665	3,936	15,492
Lezhë	42	11,19	11,00	0,242	2,822	7,963
Librazhd	21	10,82	11,00	0,234	2,080	4,327
Lushnje	24	11,99	12,00	0,225	2,311	5,343
Malësi e Madhe	25	10,49	12,00	0,446	3,250	10,562
Mallakastër	16	8,34	9,00	0,500	2,960	8,761
Mat	21	9,31	10,00	0,337	2,759	7,612
Mirditë	20	10,61	10,00	0,353	2,710	7,345
Peqin	23	10,43	11,00	0,436	3,171	10,058
Përmet	19	11,57	12,00	0,349	2,062	4,252
Pogradec	27	11,93	13,00	0,311	2,801	7,844
Pukë	22	8,34	9,00	0,500	2,960	8,761
Sarandë	19	11,36	11,00	0,310	2,539	6,445
Shkodër	34	11,64	12,00	0,199	2,619	6,861
Skrapar	23	9,66	9,00	0,397	3,098	9,596
Tepelenë	24	10,15	10,00	0,389	2,670	7,130
Tiranë Qark	38	8,79	10,00	0,333	3,334	11,117
Tirane Qytet	78	11,33	12,00	0,167	2,643	6,988
Tropojë	34	9,95	10,00	0,379	2,459	6,046
Vlore	43	10,74	11,00	0,287	2,642	6,980
Total	1062	10,69	11,00	0,054	2,936	8,621

Në tabelën përbri janë paraqitur arritjet e nxënësve për çdo DAR\ZA.
 Mesatarisht çdo nxënës ka fituar 10 pikë, pra gjysmën e pikëve të dhëna në test.

Siç shihet dhe nga tabela:

- Më dobët paraqiten rrethet: Kurbin, Mallakastër, Pukë
- Më mirë paraqiten rrethet Lushnjë, Përmet, Pogradec, Shkodër dhe Tiranë qytet.

Arritjet e nxënësve sipas ndarjes qytet- fshat

Qytet apo fshat	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Fshat	464	10,67	11,00	,080	2,796	7,818
Qytet	598	10,71	11,00	,071	3,028	9,168

Arritjet e nxënësve sipas gjinisë

Gjinia	N	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
F	473	10,87	11,00	,076	2,885	8,321
M	589	10,54	11,00	,075	2,973	8,840
Total	1062	10,69	11,00	,054	2,936	8,621

Arritjet e nxënësve sipas llojit të shkollave

Publike, Private	N	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Private	86	12,95	14,00	,135	2,015	4,061
Publike	976	10,51	11,00	,055	2,923	8,545
Total	1062	10,69	11,00	,054	2,936	8,621

Arritjet e nxënësve sipas ciklit të shkollave

Lloji sipas ciklit	N	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
9VJ	776	10,70	11,00	,061	2,982	8,892
BM	164	10,76	11,00	,120	2,636	6,947
CU	122	10,37	10,00	,234	3,087	9,530
Total	1062	10,69	11,00	,054	2,936	8,621

Sikurse shihet nuk ka ndryshime në përvetësimet të programit për nxënësit qytet–fshat, llojit të shkollave apo gjinisë.

Përfundime

Megjithse rezultati në pamje të parë duket i lartë, ne gjykojme se në të ardhmen do të dalin probleme të mëdha në aftësimin e nxënësve dhe konkretisht në:

- njohuritë gjeometrike
- në zgjidhjen e problemave.

Për këtë duhet:

1. Rishikimi i kurrikulës, me qëllim trajtimin më të plotë dhe të larmishëm të këtyre koncepteve.
2. Duhet të rritet puna e mësuesit në lidhje me natyrën e këtyre kërkesave.
3. Trajnim i mësuesve nga specialistë matematike.

DITURI NATYRE

Qëllimi kryesor i testit të Diturisë së Natyrës ishte vlerësimi i njohurive dhe aftësive që nxënësit kanë marrë, gjatë vitit mësimor, sipas objektivave të programit lëndor.

Vlerësimi kombëtar për klasën e tretë, rezultoi në një test të kombinuar, ku peshën më të madhe e pati Gjuha shqipe dhe Matematika, ndërsa lënda e Diturisë së Natyrës, për shkak të orëve më të kufizuara në programin lëndor, pati një peshë relativisht të ulët. Kjo lëndë në test u përfaqësua nga 10 pikë.

Disa nga objektivat e programit, që u testuan ishin:

Nxënësit janë në gjendje:

- të analizojnë lidhjen ndërmjet fërkimit dhe lëvizjes
- të përcaktojnë materialet që mund të magnetizohen (p.sh., hekur, nikel).
- të përshkruajnë pjesët kryesore të bimëve (rrënja, kërcelli, gjethja, lulja, fara, fryti) dhe rolin e tyre
- të dallojnë njësitë bazë të matjeve;
- të përcaktojnë dhe të përshkruajnë karakteristikat kryesore fizike në lloje të ndryshme kafshësh (jorruazorë, rruazorë)
- të listojnë vetitë kryesore të lëngjeve
- të vlerësojnë temperaturën e trupave dhe të vlerave të matura


Shpërndarja e pikëve të testit në lëndën e Diturisë së Natyrës

Sipas tabelës më poshtë, vërejmë se rreth 4% e nxënësve të klasës së tretë kanë marrë 0-1 pikë dhe rreth 20% i kanë marrë të gjitha pikët e mundshme.

Pikë	0-1	2-3	4-5	6-7	8	9	10
Nota	4	5	6	7	8	9	10
Nr nx	42	44	59	378	219	107	213

Tabela 1

Më poshtë është paraqitur grafiku i shumës së pikëve të fituara nga nxënësit. Shpërndarja e pikëve është zhvendosur pak nga e djathta. Konkretisht kemi një përqendrim më të madh të nxënësve në intervalin 6 – 7 pikë.



Grafiku 2

Përqindjet e përgjigjeve të sakta për çdo pyetje

	Pyetja 1	Pyetja 2	Pyetja 3	Pyetja 4	Pyetja 5	Pyetja 6	Pyetja 7
0 pikë	25.71%	28.81%	25.99%	46.61%	11.58%	21.19%	26.27%
1 pikë	24.11%	71.19%	74.01%	53.39%	88.42%	78.81%	56.12%
2 pikë	33.90%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	17.61%
3 pikë	16.29%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Tabela 4

Tabela 4 tregon përqindjet e nxënësve që i janë përgjigjur secilës pyetje. Shohim se nxënësit kanë dalë më mirë në pyetjen mbi pjesët e bimës dhe leximin e termometrit, ndërsa më dobët në pyetjen mbi përcaktimin e kafshëve në ruazorë dhe jorruazorë. Gjithashtu, një përqindje shumë e vogël e nxënësve kanë dhënë përgjigje të saktë në pyetjen që analizon lidhjen midis lëvizjes dhe fërkimit. Pyetja përbëhet nga dy kërkesa. Në kërkesën e parë ku nxënësit thjesht duhet të përcaktonin se ku është më e vështirë të ecësh: në rrëzë apo në asfalt, rreth gjysma e tyre i janë përgjigjur saktë. Ndërsa kërkesës së dytë, ku iu duhet të shpjegojnë arsyen, vetëm 17% i kanë dhënë përgjigje të saktë. Pra nxënësit hasin vështirësi në pyetjet që duan shpjegime.

Në tabelën 6 është dhënë numri i nxënësve që ishin prezent ditën e provimit dhe numri i nxënësve që munguan.

Pjesëmarrja e nxënësve në testim është 90.5% ndërsa përqindja e mungesave 9.5 %

Rastet					
Te perfshire		Mungesa		Total	
N	Perqindja	N	Perqindja	N	Perqindja
1062	90,5%	111	9,5%	1173	100,0%

Tabela 6

Mesatarja kombëtare e arritjes, gabimi standard

Nr i nx	Mesatarja	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
1062	6,35	0,036	1,350	1,804

Tabela 7

Mesatarja e pikëve në nivel kombëtar në lëndën e Diturisë së Natyrës është 6.35 pikë.

Pikët mesatare sipas DAR\ZA

DAR/ZA	Nr i nx.	Mesatarja	Gabimi standart i mesatares	Devijimi standart
Berat	34	5,69	0,162	1,548
Bulqizë	19	5,17	0,241	1,666
Delvinë	12	5,59	0,266	1,535
Devoll	15	6,62	0,129	,842
Dibër	32	5,69	0,150	1,357
Durrës	63	6,06	0,118	1,410
Elbasan	51	5,62	0,139	1,590
Fier	54	6,23	0,103	1,200
Gjirokastrë	32	6,60	0,085	,736
Gramsh	16	6,60	0,125	,688
Has	18	5,78	0,274	1,313
Kamëz	21	5,61	0,197	1,577
Kavajë	21	5,72	0,202	1,738
Kolonjë	14	5,78	0,273	1,617
Korçë	24	5,90	0,151	1,400
Krujë	21	5,69	0,178	1,498
Kucovë	12	5,57	0,303	1,319
Kuçovë	18	5,21	0,323	1,915
Kukës	17	6,39	0,148	,980
Kurbin	15	4,47	0,287	1,698
Lezhë	42	6,17	0,122	1,314
Librazhd	21	5,97	0,149	1,269
Lushnjë	24	6,40	0,111	1,062
Malësi e Madhe	25	5,37	0,191	1,362
Mallakastër	16	4,90	0,297	1,761
Mat	21	5,17	0,213	1,702
Mirditë	20	5,18	0,184	1,382
Peqin	23	6,97	0,205	1,465
Përmet	19	6,41	0,157	,932
Pogradec	27	6,13	0,137	1,173
Pukë	22	4,90	0,297	1,761
Sarandë	19	5,68	0,200	1,591
Shkodër	34	6,09	0,106	1,246
Skrapar	23	5,16	0,211	1,613
Tepelenë	24	5,54	0,253	1,720
Tiranë Qark	38	6,90	0,183	1,747
Tirane Qytet	78	6,13	0,086	1,162
Tropojë	34	5,30	0,201	1,295
Vlorë	43	6,13	0,130	1,131

Tabela 8

Në tabelën 8 janë paraqitur pikët mesatare sipas DAR/ZA.

Siç shihet dhe nga tabela:

- mesataren më të lartë të pikëve e ka ZA. Peqini;
- mesataren më të ulët e ka ZA. Kurbin;
- numrin më të madh të nxënësve pjesëmarrës e ka Tirana Qytet;
- numrin më të vogël të nxënësve pjesëmarrësve e ka Kuçova dhe Delvina.
- DAR/ZA me mesatare të pikëve poshtë mesatares në nivel kombëtar janë: Pukë, Tropojë, Skrapar, Sarandë, Kurbin, Mirditë , Mat dhe Malësi e Madhe
- DAR/ZA me mesatare të pikëve mbi mesataren në nivel kombëtar janë: Tiranë Qark, Peqin, Gjirokastrë, Gramsh dhe Devoll

Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 6.35;

Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë është 0,036

Devijimi standard është masa e variacionit ose shpërhapjes së të dhënave, apo shpërndarjes së probabilitetit.

Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash.

Arritjet e nxënësve sipas ndarjes qytet- fshat

Qytet apo fshat	Nr I nx	Mesatarja	Gabimi standart I mesatares	Devijimi standart	Varianca
Fshat	464	5,94	,037	1,275	1,626
Qytet	598	6,37	,033	1,387	1,923
Total	1062	6,35	0,036	1,350	1,804

Tabela 9

Sipas ndarjes në bazë të urbanizimit shihet se arritjet e nxënësve në zonat urbane janë më të larta se në zonat rurale, me një notë mesatare 6.37 përkundrejt 5.89.

Arritjet e nxënësve sipas gjinisë

Gjinia	Nr i nx.	Mesatarja	Gabimi standart i mesatares	Devijimi standart	Varianca
F	473	6,25	,048	1,351	1,826
M	589	6,89	,074	1,336	1,785
Total	1062	6,35	0,036	1,350	1,804

Tabela 10

Sipas ndarjes në bazë të gjinisë, arritjet e djemve janë më të larta kundrejt vajzave, respektivisht me një notë mesatare 6.89 përkundrejt 6.25.

Arritjet e nxënësve sipas llojit të shkollave

Publike/ Private	Nr i nx	Mesatarja	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Private	86	5,98	,051	,759	,577
Publike	976	6,46	,026	1,364	1,861
Total	1062	6,35	0,036	1,350	1,804

Tabela 11

Po të krahasojmë mesataren e pikëve sipas llojit të shkollave, shkollat publike kanë arritje më të larta kundrejt shkollave private. Kështu, mesatarja e pikëve në shkollat publike është 6.46 pikë, ndërsa në shkollat private 5.89 pikë.

Arritjet e nxënësve sipas ciklit të shkollave

Lloji sipas ciklit	Nr. i nx.	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard
9VJ	776	5,92	,028	1,343	1,803
BM	164	6,37	,058	1,267	1,606
CU	122	6,44	,115	1,515	2,296
Total	1062	6,35	0,036	1,350	1,804

Tabela 12

PJESA III

KLASA V

Programi dhe struktura e testit në gjuhën shqipe

Për hartimin e kërkesave të testit të gjuhës shqipe për klasën e 5^{-të}, punoi një grup i përbërë nga mësues të ciklit të ulët dhe specialistë lëndorë të vlerësimit.

Vlerësimi i nxënësve në gjuhën shqipe përmbante një shumëllojshmëri kërkesash. Programi i vlerësimit përfshiu ata objektiva që duhet të jenë realizuar për periudhën shtator 2013-prill 2014. E gjithë procedura e kryer është si më poshtë:

- **Përzgjedhja e objektivave kryesorë të testit (nga programi i klasës së 5^{-të});**
- **Përcaktimi i peshave të objektivave (bazuar në programin e gjuhës shqipe, klasa. 5^{-të});**
- **Përcaktimi i niveleve të taksonomisë;**
- **Grupimi i objektivave sipas niveleve të taksonomisë;**
- **Hartimi i tabelës së specifikimeve;**
- **Hartimi i pyetjeve të testit;**
- **Përgatitja e skemës së vlerësimit.**

Tabela 1 (tabela e specifikimeve) ilustron linjat dhe nënlinjat si dhe përqindjet që i takojnë çdo linje. Ndarja është bërë për qartësimin e aftësive që zotëron nxënësi dhe vlerësimin e tyre. Njëkohësisht është mbajtur parasysh se ato janë mësuar të integruara me njëra-tjetrën dhe shpesh janë parë të tilla edhe në kërkesat e testit.

Linjat/objektivat	Pesha	Pikët	Njohja/Kup	Zbatimi	Analiza/Sinteza
IV. Të lexuarit <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë informacionin më të rëndësishëm. • të tregojë brendinë e pjesës që lexon. • të identifikojë mesazhin e pjesës që lexon. • të analizojë personazhin kryesor. • të gjejë idetë dhe mesazhin e pjesës së lexuar duke i ilustruar ato me fragmentet përkatëse 	43%	7	3	3	1
V. Të shkruarit <ul style="list-style-type: none"> • të parashikojë zgjidhje, mbyllje të reja të tregimeve sipas imagjinatës. • të renditë sipas rrjedhës logjike paragrafët në hartimin e një teksti. • të shkruajë tregime të shkurtra ku të përdorin fjalë të zgjedhura 	12%	3	1	1	1
VI. Njohuri gjuhësore <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë grupin emëror dhe grupin foljor në fjali. • të përcaktojë klasën e fjalëve 	45%	10	1	3	1

të ndryshueshme dhe të pandryshueshme					
<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë numrin e emrit, • të përcaktojë mënyrën e shprehjes së veprimit nga folja. • të shkruajë saktë fjalët, shenjat e pikësimit dhe shkronjën e madhe. • të gjejë përbërësit e fjalës 					

Ndërtimi i testit dhe instrumentet e vlerësimit

Testi i gjuhës shqipe u kompozua me dy pjesë. Pjesa e parë vlerësoi njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në lexim. Ai përmbante një fragment leximi dhe disa pyetje që lidheshin me të. Pjesa e dytë vlerësoi njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në gjuhën shqipe. Pyetjet ishin të formateve të ndryshme: me zgjedhje (alternativa), me plotësim dhe me përgjigje të shkurtër.

Në linjën *Të shkruajmë*, nxënësit duhej të shkruanin histori, mbështetur në disa fjalë kyç

Testi u shoqërua me një skemë pikëzimi, ku u detajua përgjigjja e mundshme që nxënësi mund të jepte për çdo kërkesë.

Arritjet e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe

Më poshtë do të paraqesim një përshkrim dhe portretizim të arritjeve të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe për klasën e 5^{-të}, shpërndarjen e arritjeve sipas niveleve të ndryshme, çfarë janë në gjendje të bëjnë nxënësit e niveleve të ndryshme dhe disa nga gjetjet interesante që dolën nga analiza e të dhënave.

Për të pasur të dhëna krahasuese, nxënësit u kategorizuan sipas katër niveleve të arritjeve, si në tabelën më poshtë.

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Shumë mirë)
Pikët	0-5 pikë	5-11 pikë	12-16 pikë	17-20 pikë
Nr. i nxënësve	168	280	449	394
%	13.01%	21.68%	34.77%	30.51%

- Totali i nxënësve pjesëmarrës: 1291.
- 78 nxënës kanë marrë pikët maksimale: 20 pikë.
- Numri më i madh i nxënësve është përqendruar në intervalin 12-16 pikë, që i takon nivelit mirë.

Përshkrimi i niveleve

Niveli 0: në të bëjnë pjesë nxënësit që nuk kanë arritje të mjaftueshme për t'u quajtur kalues.

Niveli 1: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë njohuritë dhe shprehitë bazë të gjuhës shqipe, p.sh: të përcaktojnë klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme, të përcaktojnë numrin e emrit, të tregojnë se e kuptojnë përmbajtjen e pjesës, të identifikojë informacionin më të rëndësishëm.

Shembull pyetjeje

Pyetja 11 (77.98%)

Pse kastorët ishin të nervozuar?

Objektivi: Të identifikojë informacionin më të rëndësishëm..

Procesi: Njohja dhe të kuptuarit

Niveli 2: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë të gjitha aftësitë që zotërojnë nxënësit e nivelit të parë, por nga ana tjetër ata shfaqin edhe një sërë aftësisht më të larta si: të identifikojnë mesazhin e pjesës që lexon, të vendosin shenjat e pikësimit në një dialog, të analizojnë personazhin kryesor, të shkruajnë mesazhin e pjesës që lexuan, të formojnë një tekst me disa fjali të lidhura midis tyre, të ndërtojnë fjali që shprehin një këshillë, të identifikojë informacionin më të rëndësishëm.

Shembull pyetjeje

Pyetja 7 (56.99%)

Gjeni parafjalën e fjalës përshtas..

Objektivi: Të gjejë përbërësit e fjalës.

Procesi: Zbatimi dhe analiza

Niveli 3: përfshin nxënësit me arritjet më të larta (12-15 pikë, 43.5% e nxënësve). Këta nxënës zotërojnë aftësi të larta për të shkruar një tekst të organizuar mirë, qartë dhe pa gabime, të parashikojnë zgjidhje, mbyllje të reja të tregimeve sipas imagjinatës, të rendisin sipas rrjedhës logjike paragrafët në hartimin e një teksti. Ata njohin qartë njohuritë gjuhësore.

Shembull pyetjeje

Pyetja 9

Krijoni një tekst duke u mbështetur në fjalët kyç..

Objektivi: Të shkruajë tregime të shkurtra ku të përdorin fjalë të zgjedhura.

Procesi: Reflektim dhe përgjigje personale

Në tabelën 1 jepen përqindjet e nxënësve që dhanë përgjigje të sakta për secilën prej pyetjeve të gjuhës shqipe (testi me pyetjet është në fund të materialit).

	P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12	P 13
0 pikë	13.71%	7.67%	19.25%	19.39%	50.92%	12.05%	36.51%	28.48%	20.95%	16.12%	36.51%	29.47%	33.95%
1 pikë	77.98%	84.02%	72.44%	72.30%	40.77%	12.34%	55.18%	41.90%	56.46%	24.22%	55.18%	44.32%	17.54%
2 pikë	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	49.34%	0.00%	21.31%	14.28%	51.35%	0.00%	17.90%	15.84%
3 pikë	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	24.36%
Total	13.71%	7.67%	19.25%	19.39%	50.92%	12.05%	36.51%	28.48%	20.95%	16.12%	36.51%	29.47%	33.95%

Tabela 1

Nëse do t'i referoheshim **pyetjes 13**, e cila kërkon që nxënësit të shkruajnë një tekst duke u mbështetur në disa fjalë kyçvihen re vështirësi serioze për t'iu përgjigjur pyetjes. Vëmë re se 33.95% e popullatës nuk ka shkruar asgjë në lidhje me këtë pyetje ose përpjekjet për të komunikuar një ide me shkrim kanë qenë të pamjaftueshme për të marrë pikë. Ndërkohë 17.54% e nxënësve kanë marrë vetëm 1 pikë, që do të thotë se tek ata vihet re një përpjekje minimale për të dhënë një ide, por janë të paqartë në atë që duna të shprehin, të paorganizuar dhe teksti i shkruar përmban shumë gabime drejtshkrimore apo shenja pikësimi. Vetëm 24.36% e tyre kanë marrë pikët maksimale për këtë pyetje. Shifra është e ulët, po të kemi parasysh se qëllimi i lëndës së gjuhës shqipe është që t'i aftësojë nxënësit të shprehin dhe shkruajnë idetë e tyre në lidhje me tema të caktuara dhe jo thjesht të mbartin aftësi mekanike që shfaqen vetëm në zgjidhje fragmentare ushtrimesh.

Nëse do të shikonim me kujdes **pyetjen 5** (të gjejnë një titull tjetër të përshtatshëm për pjesën) edhe pse kjo pyetje është e nivelit të parë, rezultati na tregon një përqindje të konsiderueshme të nxënësve që nuk e kanë gjetur, 50.92% e tyre kanë marrë 0 pikë. Ky është një objektivi që i takon klasës IV dhe që përsëritet vazhdimisht, sa herë që ata kanë pjesë leximi letrar, ndaj mbetet për t'u komentuar ky rezultat.

Në tabelat 3 dhe 4 janë dhënë mesatarja kombëtare e arritjes dhe gabimi standard.

Të paraqitur		Mungesa		Total	
Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja
1291	91.7%	117	8.3%	1408	100.0%

Tabela 3

Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
1291	13.98	10.00	0.057	3.461	1291

Tabela 4

Pjesëmarrja në testim është 91 % ndërsa përqindja e mungesave 8.3 %.

Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 13.98

Vlera e mesme e arritjeve është 10.00.

Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.057.

Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash. Në rastin tonë devijim standard 3.461 tregon se shumica e nxënësve kanë marrë pikët në intervalin 6 deri në 16.

Histogrami i fig. 5 jep vizualisht një ide më të qartë të shpërndarjes së arritjeve kombëtare në gjuhën shqipe.




Fig. 5

Përfundimet e mësipërme u nxorën nga kampioni i nxënësve që dhanë testin e gjuhës shqipe për klasën e 5^{-të}, prej 1291 vetash, të cilët përfaqësuan të gjithë popullatën e nxënësve të klasës së pestë në Shqipëri.

Arritjet sipas ciklit të shkollave

Qytet apo fshat	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Fshat	531	12.36	0.089	3.564	531	12.36
Qytet	760	14.01	0.073	3.268	760	14.01
Total	1291				1291	

Tabela 6

Në tabelën 6 ju do të gjeni arritjet kombëtare sipas lokalitetit të shkollave. Vëmë re se nxënësit e qytetit kanë diferencë nga ata të fshatit.

Arritjet e nxënësve sipas ciklit të shkollave

Lloji sipas ciklit	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
9VJ	921	13.63	0.065	3.472	921
BM	230	12.04	0.129	3.487	230
CU	140	13.01	0.277	2.876	140
Total	1291				1291

Tabela 7

Nga tabela 7 vëmë re se pjesa më e madhe e nivelit të arritjeve ishte në shkollat 9-vjeçare, krahasuar me ato BM dhe CU.

Arritjet e nxënësve sipas gjinisë

Gjinia	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
F	14.51	0.077	3.464	14.51	0.077
M	12.11	0.082	4.032	12.11	0.082
Total					

Tabela 8

Nga tabela 8 vëmë re se femrat kanë arritje më të lartë se meshkujt në gjuhën shqipe.

Arritjet e nxënësve sipas ciklit të shkollave

Publike, Private	Mesatarja	Gabimi standart I mesatares	Devijimi standart
Private	14.12	0.017	2.403
Publike	13.11	0.063	3.567
Total			

Tabela 9

Nga tabela mund të dallojmë se arritjet e nxënësve në shkollat JoPublike janë më të larta se ato të nxënësve të shkollave publike.

Pikët mesatare sipas DAR/ZA

DAR/ZA	Nr i nx	Mesatarja	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard
Berat	39	10.07	0.548	3.846
Bulqizë	15	8.59	0.746	3.765
Delvinë	24	11.39	0.821	3.079
Devoll	39	12.47	0.531	2.717
Dibër	37	10.37	0.525	3.310
Durrës	74	10.70	0.468	3.645
Elbasan	78	12.70	0.420	2.691
Fier	56	11.85	0.432	3.382
Gjirokastrë	37	13.61	0.526	2.295
Gramsh	33	11.48	0.686	2.909
Has	20	10.01	0.641	2.987
Kamëz	28	11.50	0.520	3.313
Kavajë	38	12.50	0.503	2.873
Kolonjë	11	12.06	0.667	2.790
Korçë	29	13.08	0.415	2.537
Krujë	52	10.89	0.546	3.565
Kuçovë	19	12.30	0.664	3.029
Kukës	61	10.48	0.482	2.860
Kurbin	27	9.27	0.586	2.937
Lezhë	26	10.34	0.496	2.733
Librazhd	34	12.17	0.567	2.781
Lushnje	27	12.79	0.472	2.739
Malësi e Madhe	20	11.85	0.734	3.534
Mallakastër	38	11.22	0.736	3.580
Mat	35	9.69	0.680	3.746
Mirditë	31	12.01	0.579	2.318
Peqin	36	12.81	0.522	2.616
Përmet	19	12.87	0.743	2.944
Pogradec	14	13.31	0.549	2.482
Pukë	18	11.30	0.818	3.009
Sarandë	36	11.78	0.608	3.331
Shkodër	37	13.58	0.393	2.145
Skrapar	20	10.71	0.904	3.778
Tepelenë	14	9.75	0.834	3.636
Tiranë	55	13.03	0.392	2.487
Tirana Qark	28	12.20	0.550	2.577
Tropojë	18	11.62	0.781	3.870
Vlorë	68	12.78	0.445	2.709

Tabela 10

Në tabelën 10 janë paraqitur arritjet e nxënësve për çdo DAR\ZA.

Siç shihet dhe nga tabela:


- mesataren më të lartë të pikëve e ka Gjirokastra;
- mesataren më të ulët e ka Bulqiza;
- numrin më të madh të nxënësve pjesëmarrës e ka Elbasani;
- numrin më të vogël të pjesëmarrësve e ka Kolonja.

MATEMATIKË – KLASA V

Shpërndarja e pikëve

Pikë	0-5	6-8	9-11	12-14	15-16	17-18	19-20	20
Nota	4	5	6	7	8	9	10	
Nr nx	275	174	184	179	195	188	96	31

- Kalushmëria: 74,36%
- Nota 5-6: 27,73 %
- Nota 7-8: 28,96 %
- Nota 9-10: 22 %
- Nota 10: 2,9%
- Nota mesatare: 5.6



Grafiku i mësipërm paraqet shpërndarjen e pikëve për pyetjet e Matematikës

	Pyetja 1	Pyetja 2	Pyetja 3	Pyetja 4	Pyetja 5	Pyetja 6	Pyetja 7	Pyetja 8	Pyetja 9
0 pikë	32,61%	16,96%	43,45%	36,02%	20,06%	43,45%	52,52%	38,57%	16,19%
1 pikë	67,39%	28,04%	56,55%	18,67%	27,96%	26,41%	47,48%	10,53%	28,81%
2 pikë	0,00%	28,58%	0,00%	45,31%	51,98%	30,13%	0,00%	7,82%	26,80%
3 pikë	0,00%	15,57%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	43,07%	16,73%
4 pikë	0,00%	10,84%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	11,46%

Tabela 11

Nga tabela e mësipërme na rezulton se:

- 32 % e nxënësve nuk dinë të shkruajnë numrorët e dhënë me fjalë.
- Gati gjysma e nxënësve nuk dinë të kryejnë veprime matematike.
- 43% e nxënësve nuk dinë të bëjnë rumbullakimin e numrave të plotë.
- 45% e nxënësve dinë të kryejnë saktë veprimet me numra dhjetorë.
- 51 % e nxënësve dinë të kryejnë saktë veprimet me thyesa.
- 43% e nxënësve nuk dinë të zgjidhin ekuacionin.

- Shqetësues mbetet përvetësimi i njohurive gjeometrike ku 45% e nxënësve marrin 0 pikë.
- Dobësi të theksuara nxënësit kanë në zgjidhjen e problemit ku vetëm 27 % e tyre arrijnë të veprojnë.

Mesatarja kombëtare e arritjes, gabimi standard

Te paraqitur		Mungesa		Total	
Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja
1291	91,69%	117	5,95%	1408	100,00%

Tabela 12

Pikët mesatare

Nr I nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
1.291	9,09	9	0,072	4,3689	19,09

Tabela 13

- Pjesmarrjanë testim është 91.69% ndërsa përqindja e mungesave 5.95 %
- Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 8.09
- Vlera e mesme e arritjeve është 8.00
- Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.072
- Devijimi standard është masa e variacionit ose shpërhapjes së të dhënave apo shpërndarjes së probabilitetit.
- Devijimi standart i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash.

Pikët mesatare sipas DAR\ZA

DAR/ZA	Nr i nx	Mesatarja	Mediani	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Berat	39	6,49	6	0,4014	4,82	23,20
Bulqizë	15	4,01	3	0,4644	3,44	11,86
Delvinë	24	7,97	9	0,8282	4,46	19,89
Devoll	39	7,67	8	0,4344	3,96	15,66
Dibër	37	6,90	7	0,3275	3,66	13,41
Durrës	74	6,90	6	0,2876	4,30	18,45
Elbasan	78	8,89	9	0,3214	4,43	19,62
Fier	56	8,93	10	0,2744	4,45	19,80
Gjirokastrë	37	10,94	11	0,4381	3,48	12,09
Gramsh	33	7,26	7	0,6332	4,15	17,24
Has	20	5,68	5	0,4504	3,34	11,16
Kamëz	28	7,37	7	0,3899	4,43	19,61
Kavajë	38	7,80	8	0,3698	3,90	15,18
Kolonjë	11	9,16	9	0,5437	3,57	12,71
Korçë	29	9,92	11	0,3163	4,24	18,01
Krujë	52	5,92	5	0,3922	4,40	19,39
Kuçovë	19	8,04	9	0,5954	4,25	18,08
Kukës	61	7,75	8	0,3299	3,72	13,82
Kurbin	27	5,77	5	0,5280	4,42	19,51
Lezhë	26	6,92	7	0,3983	4,10	16,81
Librazhd	34	8,20	9	0,4762	3,98	15,87
Lushnje	27	8,75	9	0,3816	4,30	18,49
Malësi e Madhe	20	8,63	9	0,6186	4,42	19,52
Mallakastër	38	8,21	8	0,5285	3,81	14,52
Mat	35	4,75	4	0,4471	3,77	14,19
Mirditë	31	8,47	8	0,4169	2,86	8,17
Peqin	36	8,78	9	0,4179	3,78	14,32
Përmet	19	7,80	7	0,6991	4,14	17,11
Pogradec	14	11,56	12	0,3785	3,00	9,03
Pukë	18	5,36	5	0,6262	3,31	10,98
Sarandë	36	8,98	9	0,4873	4,33	18,76
Shkodër	37	10,55	11	0,2430	3,13	9,80
Skrapar	20	6,91	7	0,8341	4,79	22,96
Tepelenë	14	4,92	6	0,5786	3,57	12,72
Tiranë	55	9,05	10	0,2883	4,28	18,28
Tirana Qark	28	6,72	6	0,4300	3,52	12,39
Tropojë	18	7,69	7	0,6365	4,55	20,66
Vlorë	68	9,31	10	0,3515	4,36	19,02
Total	1291	8,09	8	0,0723	4,37	19,09

Tabela 14

Në tabelën përbri janë paraqitur arritjet e nxënësve për çdo DAR\ZA/

Çdo nxënës mesatarisht ka fituar 9 pikë, pra më pak se gjysma e pikëve të testit.

Më dobët paraqiten rrethet: Berat; Dibër; Durrës; Kamëz; Kavajë; Lezhë.

Me arritje shumë të dobta paraqiten rrethet: Bulqizë; Has; Krujë; Mat.

Arritjet e nxënësve sipas ndarjes qytet- fshat

Qytet apo fshat	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Fshat	531	7,31	7,00	0,10	4,17	17,38
Qytet	760	8,58	9,00	0,10	4,44	19,73
Total	1291					

Arritjet e nxënësve sipas gjinisë

Gjinia	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
F	587	9,21	9	0,10	4,36	18,97
M	704	7,83	8	0,10	4,37	19,14
Total	1291					

Arritjet e nxënësve sipas llojit të shkollave

Publike, Private	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Private	175	9.93	12	0,22	3,80	14,44
Publike	1116	8.47	8	0,07	4,32	18,70
Total	1291					

Arritjet e nxënësve sipas ciklit të shkollave

Lloji sipas ciklit	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
9VJ	921	7,97	8	0,08	4,38	19,19
BM	230	8,23	9	0,16	4,38	19,19
CU	140	7,80	8	0,38	3,95	15,62
Total	1291					

Nuk ka dallime të mëdha përsa i përket llojit të shkollave, gjinisë apo ndarjes qytet – fshat.

Nga analiza vëmë re se rezultatet në matematikë nuk janë të kënaqshëm

Për këtë duhet:

1. rishikimi i kurrikulës me qëllim trajtimin më të plotë dhe të larmishëm të këtyre koncepteve.
2. të rritet puna e mësuesit në lidhje me natyrën e këtyre kërkesave.
3. trajnim i mësuesve nga specialistë matematike.
4. forcimi i kontrollit të punës së mësuesit.

DITURI NATYRE- KLASA V

Qëllimi kryesor i testit të Diturisë së Natyrës për klasën e pestë ishte vlerësimi i njohurive dhe aftësive që nxënësit kanë marrë, gjatë vitit mësimor, sipas objektivave të programit lëndor.

Vlerësimi kombëtar për klasën e pestë, rezultoi në një test të kombinuar, ku peshën më të madhe e pati Gjuha shqipe dhe Matematika, ndërsa lënda e Diturisë së Natyrës, për shkak të orëve më të kufizuara në programin lëndor, pati një peshë relativisht të ulët. Kjo lëndë në test u përfaqësua nga 10 pikë.

Disa nga objektivat e programit, që u testuan ishin:

Nxënësit janë në gjendje:


- të shpjegojnë si krijohen eklipset e Hënës dhe të Diellit dhe të bëjë dallimin midis tyre
- të përshkruajnë strukturën e vullkanit
- të dallojnë tingujt e ndryshëm
- të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionin e rrënjës
- të përshkruajnë ndërtimin e qelizës
- të argumentojnë funksionet kryesore të pjesëve të qelizës

Pjesëmarrja e nxënësve në testim është 91.7% ndërsa përqindja e mungesave 8.3 %

Shpërndarja e pikëve

Pikë	0-1	2-3	4-5	6-7	8	9	10
Nota	4	5	6	7	8	9	10
Nr nx	27	41	121	189	345	423	145

Tabela 1



Grafiku 2

Histograma paraqet shpërndarjen e pikëve për pyetjet e Diturisë së Natyrës. Shihet qartë që përqindja më e madhe është përqendruar në intervalin 8-9 pikë.

	Pyetja 1	Pyetja 2	Pyetja 3	Pyetja 4	Pyetja 5	Pyetja 6
Mungesa	8.31%	8.31%	8.31%	8.31%	8.31%	8.31%
0 pikë	14.28%	13.85%	30.40%	22.16%	10.51%	11.22%
1 pikë	77.41%	77.84%	61.29%	32.24%	64.84%	69.32%
2 pikë	0.00%	0.00%	0.00%	16.41%	16.34%	11.15%
3 pikë				20.88%		
Total	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

Tabela 3

Tabela 3 pasqyron përqindjet e nxënësve që i janë përgjigjur pyetjeve të testit në diturinë e natyrës.. Kështu, në pyetjet me alternativa (të cilat janë pyetje të nivelit bazë), nxënësit kanë dalë shumë mirë. Për shembull në pyetjen e parë dhe të dytë, rreth 78 % e nxënësve janë përgjigjur saktë.

Nxënësit paraqesin vështirësi në pyetjet e hapura, ku ata duhet të shkruajnë apo të japin shpjegime. Në pyetjen 6, ku nxënësve iu kërkohet të shkruajnë funksionet kryesore të dy pjesëve të qelizës, vetëm 11% e tyre kanë marrë pikët e plota.

Tabela 5 pasyron numrin e nxënësve pjesëmarrës dhe atyre që munguan në testim së bashku me përqindjet respektive.

Të paraqitur		Mungesa		Total	
Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja	Nr i nx	Përqindja
1291	91.7%	117	8.3%	1408	100.0%

Tabela 4

Mesatarja kombëtare e arritjes, gabimi standard

Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
1291	6.31	6.00	0.021	1.274	1.624

Tabela 5

Pikët mesatare sipas DAR\ZA

Dar/za	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standart i mesatares	Devijimi standart	Varianca
Berat	39	5.65	6	0.127	1.526	2.328
Bulqizë	15	5.04	5	0.199	1.478	2.184
Delvinë	24	3.93	4	0.210	1.132	1.281
Devoll	39	6.05	6	0.134	1.219	1.485
Dibër	37	5.79	6	0.115	1.284	1.650
Durrës	74	5.43	5	0.092	1.370	1.877
Elbasan	78	5.96	6	0.082	1.131	1.279
Fier	56	5.79	6	0.079	1.282	1.645
Gjirokastër	37	6.63	7	0.076	.604	.365
Gramsh	33	5.77	6	0.194	1.269	1.611
Has	20	4.71	5	0.161	1.197	1.432
Kamëz	28	5.78	6	0.114	1.293	1.671
Kavajë	38	6.50	6	0.072	.761	.580
Kolonjë	11	5.95	6	0.156	1.022	1.045
Korçë	29	6.44	6	0.071	.953	.908
Krujë	52	6.04	6	0.108	1.209	1.462
Kuçovë	19	5.37	5	0.192	1.371	1.878
Kukës	61	5.98	6	0.119	1.336	1.785
Kurbin	27	4.83	5	0.145	1.215	1.477
Lezhë	26	5.58	6	0.136	1.400	1.961
Librazhd	34	6.04	6	0.129	1.083	1.172
Lushnje	27	6.50	6	0.091	1.030	1.061
Malësi e Madhe	20	6.18	6	0.133	.953	.908
Mallakastër	38	5.23	5	0.193	1.395	1.946
Mat	35	5.75	6	0.170	1.431	2.049
Mirditë	31	6.06	6	0.162	1.111	1.235
Peqin	36	6.23	6	0.140	1.270	1.612
Përmet	19	5.77	6	0.209	1.239	1.534
Pogradec	14	6.81	7	0.067	.535	.286
Pukë	18	5.75	6	0.245	1.295	1.676
Sarandë	36	6.49	6	0.106	.946	.894
Shkodër	37	6.73	7	0.045	.576	.332
Skrapar	20	5.85	6	0.218	1.253	1.570
Tepelenë	14	4.61	5	0.240	1.480	2.191
Tiranë	55	5.83	6	0.079	1.176	1.383
Tirana Qark	28	5.60	6	0.135	1.102	1.214
Tropojë	18	5.69	6	0.162	1.157	1.340
Vlorë	68	6.07	6	0.082	1.017	1.034
Total	1291	5.90	6	0.021	1.274	1.624

Tabela 6

Në tabelën 6 janë paraqitur arritjet e nxënësve për çdo DAR\ZA

Siç shihet dhe nga tabela:

- mesataren më të lartë të pikëve e ka Pogradeci;
- mesataren më të ulët e ka Delvina (të njëjtin rezultat ka patur ZA Delvinë edhe në fazën e parë të studimit)
- numrin më të madh të nxënësve pjesëmarrës e ka Elbasani;
- numrin më të vogël të nxënësve pjesëmarrësve e ka Kolonja.
- DAR/ZA me pikë nën mesataren e vendit janë Hasi, Kurbini dhe Tepelena.

Pjesëmarrja e nxënësve në testim është 91.7% ndërsa përqindja e mungesave 8.3 %.

Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 6.31.

Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë është 0.021.

Devijimi standard është masa e variacionit ose shpërhapjes së të dhënave, apo shpërndarjes së probabilitetit.

Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash.

Arritjet e nxënësve sipas ndarjes qytet- fshat

Fshat/Qytet	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
Fshat	531	6.31	6.00	0.032	1.285	1.652
Qytet	760	6.21	6.00	0.028	1.266	1.602
Total	1291	6.31	4.00	0.021	1.274	1.624

Tabela 7

Arritjet sipas gjinisë

Gjinia	Nr. i nx.	Mesatarja	Median	Gabimi standart i mesatares	Devijimi standart	Varianca
F	587	6,42	6,00	0,030	1,260	1,587
M	704	6,02	5,00	0,030	1,288	1,660
Total	1291	6,31	4,00	0,021	1,274	1,624

Tabela 8

Arritjet sipas llojit të shkollave

Publike, Private	Nr. i nx.	Mesatarja	Median	Gabimi standart i mesatares	Devijimi standart	Varianca
Private	175	6,21	6,00	0,049	,836	,699
Publike	1116	5,87	6,00	0,022	1,296	1,679
Total	1291	6,31	6,00	0,021	1,274	1,624

Tabela 9

Arritjet e nxënësve sipas ciklit të shkollave

Lloji sipas ciklit	Nr i nx	Mesatarja	Median	Gabimi standart i mesatares	Devijimi standart	Varianca
9VJ	921	5,78	6,00	0,024	1,281	1,640
BM	230	6,31	7,00	0,047	1,263	1,596
CU	140	6,01	6,00	0,106	1,101	1,212
Total	1291	6,31	6,00	0,021	1,274	1,624

Tabela 10

Nuk ka dallime të mëdha përsa i përket llojit shkollave, gjinisë apo ndarjes qytet – fshat, sipas tabelave 8, 9, 10 dhe 11.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

VLERËSIM KOMBËTAR

KLASA III

6 maj 2014, Ora 10.00

Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre

Emri _____

Mbiemri _____,

Udhëzime për nxënësin

Testi ka 33 kërkesa:

- 17 kërkesa gjuhë shqipe;
- 9 kërkesa matematikë;
- 7 kërkesa dituri natyre.

Testi në total ka 50 pikë:

- 20 pikë gjuhë shqipe;
- 20 pikë matematikë;
- 10 pikë dituri natyre.

Koha për zhvillimin e testit është 50 minuta:

- 22 minuta gjuhë shqipe;
- 23 minuta matematikë;
- 5 minuta dituri natyre.

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Pikë											
Kërkesa	12	13	14	15	16	17					
pikë											
Kërkesa	18	19	20	21	22	23	24	25	26		
pikë											
Kërkesa	27	28	29	30	31	32	33				
pikë											

Vlerësues: _____
Emër Mbiemër

Nënshkrimi

Gjuhë Shqipe

LISI DHE XUNKTHI

Një lisi i gjatë rritej buzë një lumi. Pranë lisit rritej një xunkth i hollë. Kur frynte puhia lisit i tundeshin vetëm gjethet, kurse xunkthi lëkundej lart e poshtë.

Një ditë lisi i tha xunkthit: “Pse e lejon erën të të trajtojë në këtë mënyrë? Qëndro drejt! Mos u përkul!” Xunkthi u përgjigj: “Nganjëherë është mirë të qëndrosh drejt, nganjëherë jo. Ti mendon se unë mposhtem nga era?! Kjo nuk është e vërtetë”. Lisi diçka mëmëriti dhe vështroi tutje.

Pas disa ditësh shpërtheu një stuhi e tmerrshme. Era frynte fort e më fort. Papritur u dëgjua një kërcitje e fortë dhe lisi u përplas përtokë. Xunkthi përkulej majtas e djathtas sipas drejtimit të erës, por kur stuhia pushoi, ai qëndroi sërish drejt.

Xunkthi-bimë barishtore që rritet në brigjet e lumenjve dhe liqeneve etj.

1. Kjo histori është një:

1 pikë

- A) fabul
- B) tregim
- C) përrallë
- D) vjershë

2. Në këtë pjesë lisi mëmërit sepse:

1 pikë

- A) kështu e kanë zakon të bëjnë pemët kur nuk u pëlqen diçka;
- B) pema mendon se është më e mirë se xunkthi;
- C) pema nuk pajtohet me atë që i tha xunkthi;
- D) pema është duke treguar se nuk ka frikë nga era.

3. Qarkoni fjalinë që duhet vendosur në kutinë e dytë.

1 pikë

- A) Puhia fryn.
- B) Xunkthi qëndron drejt sërish.
- C) Xunkthi mbron veprimet e tij.
- D) Lisi dhe xunkthi rriten krahë për krahë.

Pastaj lisi i bëri xunkthit një pyetje.

?

Një stuhi e tmerrshme ndodhi.

Lisi u përplas përtokë.

4. Cila nga fjalitë e mëposhtme e përmbledh më mirë moralin e kësaj historie?

1 pikë

- A) Është gjithmonë shumë mirë të jesh i gjatë dhe i drejtë.
- B) Është më mirë të jesh elastik, sesa kokëfortë.
- C) Është mençuri të jesh i kujdesshëm kur merresh me pemë të larta.
- D) Është më mirë të njohësh fuqitë e tua se ato të shokëve të tu.

5. Qarkoni fjalën e shkruar saktë.

1 pikë

- A) Asnjë herë
- B) Asnjherë
- C) Asnjëherë
- D) Asnjëher

6. Pse xunkthi përkulej majtas e djathtas sa herë që frynte era? 1 pikë
- _____
7. Pse lisi u përplas në tokë? 1 pikë
- _____
8. Shkruani një karakteristikë për personazhin e xunkthit. 1 pikë
- Xunkthi _____
9. Fjalja e mëposhtme është pyetëse, dëftore apo shpreh një urdhër? 1 pikë
- Mos u përkul! _____
10. Vendosni shenjën e pikësimit në fjalinë e mëposhtme. 1 pikë
- Kur do t'i bësh detyrat ()
11. Ktheni fjalinë e mëposhtme në fjali pohore. 1 pikë
- Kjo nuk është e vërtetë. _____
12. Zgjeroni me dy grupe plotësuese fjalinë: 2 pikë
- Era frynte fort.
- _____
13. Përshtatni foljen me kryefjalën. 1 pikë
- Lisat rrit (_____) buzë lumenjve.
14. Vendosni kryefjalën në fillim të fjalisë duke ndryshuar rendin e fjalëve. 1 pikë
- Pranë lisit rritej një xunkth i hollë.
- _____
15. Gjeni kohën e foljes në fjalinë e mëposhtme. 1 pikë
- Një lis i gjatë rritet buzë një lumi. _____
16. Shkruani një pyetje për përgjigjen e mëposhtme: 1 pikë
- _____ Lisi dhe xunkthi rriten krahë për krahë.
17. Krijoni një histori të shkurtër bazuar në figurën e mëposhtme. 3 pikë



Matematikë

18. Shkruaj numërorin me fjalë.

1 pikë

1264 _____

19. Shkruaj numërorin me shifra.

1 pikë

Tetëmijë e shtatë _____

20. Kryeni veprimet:

2 pikë

$15 - 7 =$ $19 + 12 =$

21. Vendos numrin që duhet në vargun:

1 pikë

16, 19, 22, ____, 28

22. Kryej veprimet në shtyllë.

4 pikë

$\begin{array}{r} 2617 \\ +1789 \\ \hline \end{array}$	$\begin{array}{r} 7062 \\ - 1384 \\ \hline \end{array}$	$\begin{array}{r} 672 \\ \cdot 3 \\ \hline \end{array}$	$\begin{array}{r} 3\text{kg } 20\text{g} \\ - 2\text{kg } 400\text{g} \\ \hline \end{array}$
--	---	---	--

23. Vendos numërorët që vërtetojnë barazimin ose mosbarazimet.

3 pikë

{5,7,8,9,10}

$18 - \square = 11$

$4 \cdot \square > 32$

$37 + \square < 45$

24. Plotëso:

3 pikë

2-fishi i 37 + 4-fishi i 16 =

25. Vizato katrorin me brinjë 2 cm dhe gjej perimetrin e tij.

2 pikë

26. Agimi preu 236 shirita. Moza preu 29 shirita më pak se Agimi. Miri preu 17 shirita më shumë se Moza. Sa shirita preu Miri? (zgjidh problemën me kërkesa)

3 pikë

Dituri natyre

27. Rrethoni V nëse pohimi është i vërtetë dhe G nëse pohimi është i gabuar.

3 pikë

a) Metri është njësia matëse për matjen e gjatësisë.

V G

a) Lëngjet marrin formën enës ku hidhen.

V G

b) Magneti tërheq trupat prej qelqi.

V G

28. Në figurën e mëposhtme tregohen dy magnete pranë njëri tjetrit. Ç' do të ndodhë midis dy magneteve?

1 pikë

A) Ata do të shtyhen.

B) Ata do të tërhiqen.

C) Nuk do të ndodhë asgjë.




29. Pjesa e bimës e cila thith dyoksidin e karbonit dhe çliron oksigjenin është:

1 pikë

A) rrënja.

B) kërcelli.

C) gjethja.



30. Kafshët që bëjnë pjesë në grupin e jorruazorëve janë:

1 pikë

A) peshqit.

B) shpendët.

C) krimbat.

31. Vëzhgoni dy termometrat të cilët kanë matur temperaturën e ajrit ditën e hënë dhe ditën e premte.


Sa ka ndryshuar temperatura e ajrit nga dita e hënë në ditën e premte?

1 pikë

A) Temperatura është zvogëluar me 10°C.

B) Temperatura është rritur me 10°C.

C) Temperatura nuk ka ndryshuar.



32. Shkruani funksionin që kryen rrënja për rritjen e bimëve.

1 pikë

33. Në figurat e mëposhtme tregohet një vajzë që ecën në rrëre dhe një djalë që ecën në asfalt. Ku është më e vështirë të ecësh: në rrëre apo në asfalt? Argumentoni përgjigjen tuaj.

2 pikë



Më e vështirë është të ecësh në _____

Pse? _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

VLERËSIM KOMBËTAR

KLASA V

6 maj 2014, Ora 10.00

Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre

Emri _____

Mbiemri _____,

Udhëzime për nxënësin

Testi ka 28 pyetje:

- 13 pyetje gjuhë shqipe;
- 9 pyetje matematikë;
- 6 pyetje dituri natyre.

Testi në total ka 50 pikë:

- 20 pikë gjuhë shqipe;
- 20 pikë matematikë;
- 10 pikë dituri natyre.

Koha për zhvillimin e testit është 55 minuta:

- 25 minuta gjuhë shqipe;
- 25 minuta matematikë;
- 5 minuta dituri natyre.

Pyetje	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Pikë											
Pyetje	12	13									
Pikë											
Pyetje	14	15	16	17	18	19	20	21	22		
Pikë											
Pyetje	23	24	25	26	27	28					
Pikë											

Vlerësues: _____
Emër Mbiemër

Nënshkrimi

Gjuhë shqipe

Lexoni pjesën e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjeve në vazhdim.

Shumë kohë më parë, lumi Merrimak rridhte paqësisht përmes kodrave të pyllëzuara. Shumë kastorë kishin ndërtuar shtëpitë e tyre në këtë lumë ku peshq të shumtë notonin në ujërat e tij të pastra. Kaq i pastër dhe i mirë ishte uji i lumit, sa nga vende shumë të largëta vinin kafshët për të shuar etjen e tyre.

Në ato kohë të largëta, kafsha më e madhe në vend ishte dreri. Ai qëndronte aq i drejtë sa edhe pema më e lartë. Kur ecte, toka tundej nën këmbët e tij të rënda.

Një ditë, krijesa gjigante mësoi për lumin me ujëra të kristalta dhe të pastra. “Duhet të shkoj atje,- mendoi, - dhe ta provoj vetë ujin.”

Kur arriti te lumi, dreri filloi menjëherë të pinte ujë. Iu duk shumë i mire, prandaj filloi të pinte gjithnjë e më tepër. Shumë shpejt niveli i ujit filloi të binte.

Kjo i nervozoi kastorët. Çfarë do të ndodhte me shtëpitë e tyre? Ata kishin punuar shumë për t’i ndërtuar ato me baltë dhe shkopinj.

- Na ndihmoni!- iu lutën ata lepujve.

- Ne duhet ta ndalojmë drerin,- i thanë këta të fundit dhelprave.

- Largohu!- i bërtitën kastorët drerit. Por dreri ishte aq i madh sa askush, as edhe ariu nuk mund të përballej me të.

Ndërkaq, dreri vazhdonte të pinte ujin e lumit. Niveli i lumit vazhdonte të zbriste poshtë e më poshtë sa edhe peshqit filluan të trembeshin. Në fund të fundit, kastorët mund të shkonin në një shtëpi të re, por çfarë do të bënin peshqit, nëse lumi thahej?

Ata filluan të luteshin për ndihmë.

Më në fund një krijesë vendosi që ta detyronte drerin të largohej. Ishte një mizë.

- Ti je më e vogla! - bërtitën kafshët. -Si mund ta detyrosh t’i drerin e madh të largohet? Ata qeshën, duke menduar se kjo ishte një shaka e mizës.

Miza e vogël kishte një plan. Në fillim ajo u ul në njërin prej këmbëve të drerit dhe e pickoi. Dreri me një lëvizje e flaku atë tutje. Por miza fluturoi në këmbën tjetër dhe këtë herë e pickoi më me forcë. Dreri përplasi këmbën me zemërim. Miza fluturonte nga një anë e kurrizit të drerit në tjetrën duke e pickuar fort në vende të ndryshme.

Dreri sa nuk u çmend nga zemërimi. Ai shkundi kokën e tij të madhe, hungëriti, përplasi këmbët dhe hodhi shkelma. Pastaj vrapoi poshtë e lart lumit, duke u përpjekur të zbulonte se kush po e pickonte. Por ai nuk e shikonte dot mizën e vogël. Më në fund u largua nga lumi duke vrapuar me sa i hanin këmbët.

Sa krenare ishte miza e vogël! “E shikoni, - u tha ajo kafshëve të tjera, - madhësia ime nuk ka dhe aq vlerë. Unë nuk isha shumë e madhe apo e fortë për ta luftuar drerin, por isha e zgjuar!”

Kastori- kafshë, lëkura e të cilëve përdoret për çanta, këpucë.

- 1. Pse kastorët ishin të nervozuar? 1 pikë**
- A) Lumi ishte shumë i ftohtë dhe i thellë.
B) Dreri po e pinte të gjithë ujin.
C) Peshqit ishin duke notuar në drejtim të rrymës.
D) Miza ishte duke u mbytur në lumë.
- 2. Cili është ndryshimi themelor midis mizës dhe kafshëve të tjera? 1 pikë**
- A) Miza u përpoq të ndihmonte kafshët e tjera.
B) Miza është më e vjetër se kafshët e tjera.
C) Miza nuk e kupton problemin.
D) Miza është më e zgjuar se kafshët e tjera.
- 3. Cili është kuptimi i kësaj historie? 1 pikë**
- A) Mizat janë më të vogla se kafshët e tjera.
B) Lumenjtë kërcënohen për shkak të kastorëve.
C) Zgjuarsia është më e rëndësishme se madhësia.
D) Metodatat e duhura të ndihmojnë në situata të vështira.
- 4. Cila nga fjalitë e mëposhtme bën më mirë përmbledhjen e kësaj historie? 1 pikë**
- A) Një kafshë e vogël e gjen veten në vështirësi.
B) Shumë kafshë bashkohen kundër një armiku të përbashkët.
C) Një kafshë e madhe është vënë në lojë nga një kafshë e vogël.
D) Kafshët mësojnë pse dreri është akuzuar.
- 5. Vendosini një titull të përshtatshëm kësaj historie. 1 pikë**
- _____
- 6. Plotësoni: 2 pikë**
Autori e ndërton ngjarjen duke vënë përballë drerin që përfaqëson _____ dhe mizën që përfaqëson _____.
- 7. Gjeni parashtesën e fjalës *përplas*. 1 pikë**
Përplas: _____
- 8. Përcaktoni kohën dhe zgjedhimin e foljes *pinte*: 2 pikë**
Koha _____ Zgjedhim i _____
- 9. Ktheni në numrin shumës grupin emëror: 2 pikë**
Ujë i pijshëm _____
- 10. Përcaktoni në fjalinë e parë grupin e kryefjalës dhe në fjalinë e dytë grupin foljor: 2 pikë**
Miza e vogël kishte një plan. Grupi i kryefjalës: _____
Ata filluan të luteshin për ndihmë. Grupi foljor: _____

11. Përcaktoni klasën e fjalës së nënvizuar: **1 pikë**

Ata filluan të luteshin për ndihmë.

12. Emërtoni gjymtyrët e nënvizuara: **2 pikë**

Mira e vogël kishte një plan. _____

Dreri përplasi këmbën me zemërim _____

13. Krijoni një tekst duke u mbështetur nga fjalët kyç: lulëzim, lodrojnë, diell, fëmijë, fushë. **3 pikë**

Matematikë

14. Shkruaj numërorin:

1 pikë

Katërqind mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë _____

15. Kryej veprimet në shtyllë:

4 pikë

$\begin{array}{r} 41827 \\ + 25789 \\ \hline \end{array}$	$\begin{array}{r} 40104 \\ - 6837 \\ \hline \end{array}$	$\begin{array}{r} 1453 \\ \cdot 57 \\ \hline \end{array}$	$6547 : 24$
---	--	---	-------------

16. Rrumbullakos me afërsi 100 numrin.

1 pikë

2716 = _____

17. Kryej veprimet në shtyllë:

2 pikë

$18,2 + 6,9 - 7,8 =$

18. Kryej veprimet:

2 pikë

$$\frac{1}{3} + \frac{2}{5}$$

19. Zgjidh ekuacionin:

2 pikë

$9 \cdot x - 14 = 58$


20. Në një trekëndësh dy prej këndeve janë 60° dhe 80° . Gjeni këndin tjetër 1 pikë
21. Një drejtkëndësh e ka gjatësinë 12 m, kurse gjerësinë sa $\frac{1}{3}$ e gjatësisë.
Gjeni perimetrin dhe sipërfaqen e drejtkëndëshit. 3 pikë
22. Një familje e përbërë nga dy prindër dhe dy fëmijë po udhëtonin me autobus për në Sarandë. Bileta për të rritur kushton 1200 lekë, kurse për fëmijë sa gjysma e çmimit të biletës së të rriturve. Babai i dha fatorinës një kartëmonedhë 5000 lekëshe. Sa lekë do t'i kthejë fatorinoja babait? (zgjidh problemin me kërkesa). 4 pikë

Dituri natyre

23. Në figurën e mëposhtme tregohet:

1 pikë

- A) eklipsi i Hënës.
- B) eklipsi i Diellit.
- C) eklipsi i Tokës.



24. Qeliza bimore ndryshon nga qeliza shtazore sepse përmban:

1 pikë

- A) kromozomet.
- B) kloroplastet.
- C) citoplazmën.


25. Jehonë quhet _____

1 pikë

26. Emërtoni pjesët e vullkanit.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____



27. Shkruani dy funksione që kryen rrënja për rritjen e bimëve.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

28. Shkruani një nga funksionet që kryejnë secila nga këto pjesë përbërëse të qelizës.

2 pikë

- a) Membrana qelizore

- b) Bërthama
